

Security for Human Beings and Borders

Combating Smuggling of Migrants
in the Western Balkan



Funded by
the European Union

Raporti Kombëtar i Monitorimit të Kontrabandimit të Migrantëve në Shqipëri

Tiranë, Qershor 2023



BALKAN
REFUGEE AND
MIGRATION
COUNCIL

DRU DANISH
REFUGEE
COUNCIL

Raporti Kombëtar i Monitorimit të Kontrabandimit të Migrantëve në Shqipëri

Tiranë, Qershor 2023



Botuesi:

Group 484
Pukovnika Bacića 3
11000 Belgrade, Serbia
www.grupa484.org.rs

Për botuesin:

Miroslava Jelačić Kojić

Author

AHC



**Funded by
the European Union**

This publication has been produced with the assistance of the European Union under the "Security for Human Beings and Borders Combating Smuggling of Migrants in the Western Balkan". The content of this publication is the sole responsibility of the authors and may in no way be taken to reflect the views of the European Union.

RAPORT MONITORIMI: SITUATA ME KONTRABANDIMIN E MIGRANTËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Koordinoi Platformën Kombëtare dhe rishikoi raportin:

Znj. Anda Kruetani, Koordinatore Projektsh, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rishikim ligjor:

Z. Njazi Jaho, Këshilltar Ligjor, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Antarë të Platformës Kombëtare:

Albanian Initiative for Development (Znj. Anila Shehi (Dollani); **CRCA/ECPAT** (Z. Altin Hazizaj, Znj. Borjana Dine, Z. Klaudio Pulaha, Znj. Mimoza Sula); **Different and Equal** (Znj. Stela Tanellari, Znj. Ina Çela); **European Movement Albania** (Znj. Nirvana Deliu); **Gruaja te Gruaja Shkodër** (Z. Suad Arilla); **Nisma ARSIS** (Znj. Ana Majko, Z. Ditmir Lita); **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare** (Znj. Klea Cahani, Znj. Lime Skuka, Znj. Nadia Guni); **Shoqata Gazetarë Profesionistë Rajonalë** (Z. Fatos Puto); **Shoqata Multifunkionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim** (Znj. Loreta Mamani); **Shoqata "Tjetër Vizion"** (Znj. Ardiana Kasa).

Ky raport është hartuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në kuadër të zbatimit të projektit "*Siguria për qeniet njerëzore dhe kufijtë – lufta kundër kontrabandimit të migrantëve në Ballkanin Perëndimor*", financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar në partneritet me Grupin 484 (Serbi), Aleancën Qytetare (Mali i Zi), Shoqatën Maqedonase të Juristëve të Rinj, Vaša Prava Bosnje dhe Hercegovinë (E drejta juaj), Qendrën e Beogradit për të Drejtat e Njeriut, Programin për të Drejtat Civile në Kosovë dhe Këshillin Danez për Refugjatët dhe.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përcjell domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian ose partnerëve të tjerë zbatues.

Autor:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. Brigada e VIII, Pallati "Tekno Projekt" Shk 2 Ap 10,

Tirana-Albania

PO BOX no.1752;

Tel: 04 2233671; Cel: 0694075732;

E-mail: office@ahc.org.al;

Web site: www.ahc.org.al

Përmbajtja

PARATHËNIE	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
1. HYRJE	9
2. TERMINOLOGJIA	10
3. METODOLOGJIA	11
4. KAPACITETET INSTITUCIONALE NË MENAXHIMIN E MIGRACIONIT DHE LUFTIMIN E KONTRABANDIMIT TË MIGRANTËVE	12
4.1. Aktorët kyç kombëtar përgjegjës për migracionin dhe luftimin e kontrabandimit të migrantëve ..	13
4.2. Kapacitetet dhe sfidat institucionale	16
5. KONTRABANDIMI I MIGRANTËVE – VËSHTRIM NGA PRAKTIKA NË SHQIPËRI	18
5.1. Profili i migrantëve të parregullt të cilët hyjnë dhe dalin nga Shqipëria	18
5.2. Modus operandi (mënyra e veprimit) i kontrabandimit të migrantëve në Shqipëri	19
5.3. Kontrabanduesit e migrantëve	21
5.3. Migrantët e kontrabanduar	23
5.5. Bashkëpunimi me autoritetet kompetente	24
5.6. Parandalimi i kontrabandimit dhe mbrotja e migrantëve të kontrabanduar	25
6. SHTOJCA 1: PROPOZIM PËR BASHKËPUNIM MIDIS OSHC-VE DHE AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE – PROCEDURA KOMBËTARE STANDARDE TË OPERIMIT (NSOPS)	27
Fushat prioritare	27
7. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	31

Parathënie

I nderuar lexues,

Në përputhje me misionin e tij për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e njeriut dhe forcimin e shtetit të së drejtës, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) ka ndërmarrë nisma të shumta ndër vite për të monitoruar dhe mbështetur mbrojtjen e të drejtave të migrantëve, refugjatëve dhe azilkërkuesve në Shqipëri. KShH, në raportet e tij, ka paraqitur vazhdimisht rekomandime të vlefshme me qëllim rritjen e zbatimit efektiv të këtyre të drejtave.

Me qëllim analizimin e tendencave dhe hartimin e politikave për adresimin e kërkesave dhe riskut që lidhen me parandalimin e kontrabandimit dhe mbrojtjen e migrantëve të kontrabanduar, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), nëpërmjet drejtimit të Platformës Kombëtare për Parandalimin e Kontrabandimit të Migrantëve dhe Mbrojtjes së Migrantëve të Kontrabanduar në Shqipëri, ndërmori iniciativën për të monitoruar trendet kryesore në lëvizjet e parregullta të migrantëve, me një fokus të veçantë në mënyrën e veprimit të kontrabanduesve dhe shërbimet e ofruara prej tyre. Ky studim synon të vlerësojë kapacitetet institucionale në menaxhimin e migracionit dhe luftimin e kontrabandimit të tyre, si dhe ofrimin e sugjerimeve dhe rekomandimeve konkrete për përmirësimin e situatës aktuale.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit shpreh vlerësimin e tij për përpjekjet e bëra nga anëtarët e Platformës Kombëtare për Parandalimin e Kontrabandës së Migrantëve dhe Mbrojtjen e Migrantëve të Kontrabanduar, kontributet e të cilëve ishin thelbësore në përgatitjen e këtij raporti studimor. KShH gjithashtu falenderon institucionet me të cilat është vendosur dhe mirëmbajtur bashkëpunimi gjatë zbatimit të projektit, duke vlerësuar veçanërisht bashkëpunimin e tyre gjatë procesit të monitorimit dhe mbledhjes së të dhënave.

KShH gjithashtu vlerëson bashkëpunimin e frytshëm me partnerët rajonalë zbatues të projektit "Siguria për qeniet njerëzore dhe kufijtë – luftimi i kontrabandës së migrantëve në Ballkanin Perëndimor", duke përfshirë Grupin 484 (Grupa 484) në Serbi, Aleancën Qytetare (Civic Alliance) në Malin e Zi, Shoqatën Maqedonase të Juristëve të Rinj (Macedonian Young Lawyers Association) në Maqedoninë e Veriut, E Drejta Juaj (Vaša Prava) në Bosnje dhe Hercegovinë, Qendrën e Beogradit për të Drejtat e Njeriut (Belgrade Center for Human Rights) në Serbi, Programin për të Drejtat Civile (CRP/K) në Kosovë dhe Këshillin Danez për Refugjatët (Danish Refugee Council). Mbështetja dhe bashkëpunimi me këto organizata gjatë tri viteve të fundit kanë qenë të paçmueshme për suksesin e projektit. Së fundi, KShH falenderon Bashkimin Evropian për mbështetjen e vazhdueshme në promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri, dhe që bëri të mundur realizimin e këtij studimi.

Shprehim gjithashtu urimet tona më të mira, ndërsa filloni të lexoni këtë Raport Studimi.

Gjithë të mirat,

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Përmbledhje ekzekutive

Kjo përmbledhje ekzekutive ofron një vështrim të shkurtër sa i takon gjetjeve dhe konkluzioneve kryesore të nxjerra nga monitorimi i institucioneve kyçe të përfshira në kontrollin e fenomenit të migracionit dhe kontrabandimit të migrantëve. Seksionet vijuese të këtij raporti bëjnë një analizë gjithëpërfshirëse të aktorëve përkatës, kapaciteteve të tyre, tendencave dhe modeleve mbizotëruese të kontrabandimit të migrantëve në Shqipëri, profileve të kontrabanduesve dhe migrantëve të kontrabanduar, si dhe mënyrave të përdorura për të kryer aktivitetet që lidhen me kontrabandimin. Gjithashtu, raporti paraqet rekomandime drejtuar aktorëve kryesorë të përfshirë në mënyrë që të adresohen çështjet dhe sfidat e identifikuara në një mënyrë sa më efektive.

1. "Kontrabandimi i migrantëve" do të thotë shkaktimi për qëllim përfitimi financiar ose material, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i hyrjes në mënyrë të paligjshme në një Shtet Palë të një personi, në të cilin ai/ajo nuk është as shtetas e as banor i përhershëm. Në legjislacionin shqiptar, Kodi Penal përfshin dispozita specifike që lidhen me kontrabandimin. Neni 298 i Kodit Penal parashikon se *"Strehimi, shoqërimi, vënia në dispozicion ose përdorimi i mjeteve të lundrimit, të fluturimit ose i mjeteve të tjera të transportit apo çdo ndihmë tjetër, me qëllim kalimin e paligjshëm të kufirit të Republikës së Shqipërisë ose për hyrjen e paligjshme të një personi në një shtet tjetër, pa qenë shtetas i tij ose që nuk ka leje qëndrimi në atë shtet, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet."*
2. Kontrabandimi i migrantëve bie nën objektin e Kapitullit 24 të *acquis* të BE-së, i cili fokusohet në fushat e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë. Ai është i lidhur ngushtë me aspekte të ndryshme të mbuluara nga ky kapitull, si migrimi i parregullt, menaxhimi i kufijve, rregulloret e zonës Shengen, politikat e vizave të BE-së, lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe adresimi i krimit të organizuar.
3. Në Shqipëri, shërbimet kryesore të paligjshme që u ofrohen migrantëve me qëllim hyrjen ilegalisht në vend pa qenë shtetas ose pa leje qëndrimi janë strehimi, shoqërimi ose vënia në dispozicion apo përdorimi i mjeteve të transportit.
4. Shqipëria është kryesisht një vend tranzit për flukset e emigrantëve gjatë rrugës së tyre për në vendet e Bashkimit Evropian, të cilët janë destinacioni përfundimtar i preferuar i migrantëve.
5. Gjatë vitit 2022, në Shqipëri janë kapur gjithsej 12,216 migrantë të parregullt. Kjo paraqet një rënie prej 6,280 individësh krahasuar me vitin 2021, kur u kapën 18,496 shtetas të huaj të parregullt. Dy qytete u konsideruan si pikat e nxehta, Gjirokastra dhe Korça, të cilat përbënin numrin më të madh të emigrantëve të parregullt të zbuluar në vend, rreth 85% të të gjithë emigrantëve të parregullt të kapur.
6. Sa i takon kombësive kryesore të migrantëve të parregullt të kapur në Shqipëri, tendenca ka mbetur e qëndrueshme midis 2021 dhe 2022 ku kombësitë kryesore të migrantëve të parregullt të kapur janë sirianë (5,366), afganë (1,377), bangladeshas (832), marokenë (505), pakistanezë (339) dhe irakianë (305). Në vitin 2022, numrat u ulën në përgjithësi, ku kombësitë kryesore të të kapurve ishin sirianë (3,030), afganë (1,325), bangladeshas (1,055), pakistanezë (856), iranianë (311) dhe marokenë (301).
7. Për shkak të vendndodhjes strategjike gjeografike të Shqipërisë dhe vendeve fqinje që kanë përjetuar flukse të konsiderueshme migracioni, zakonisht rruga mbizotëruese përfshin hyrjen përmes pikave kufitare jugore dhe juglindore, ndjekur nga dalja përmes pikave kufitare veriore dhe verilindore, të cilat lidhin Shqipërinë me Malin e Zi dhe Kosovën. Nga ana tjetër, rrugët më pak të përdorura janë nëpërmjet aeroportit ndërkombëtar "Nënë Tereza", si dhe nga deti.
8. Migrantët prirën të përdorin rrugët malore për të kaluar në mënyrë që të shmangin zbulimin nga agjencitë e zbatimit të ligjit. Ata zakonisht përdorin zonat rurale dhe shpesh herë vërehet se migrantët kërkojnë strehim në shtëpi të braktisura dhe me kushte të këqija, duke i përdorur ato si strehim të përkohshëm përpara se të vazhdojnë udhëtimin e tyre.

1 Organizata e Kombeve të Bashkuara, Protokollin kundër kontrabandimit të migrantëve në rrugë tokësore, ajrore dhe detare, shtesë e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/protocol-against-smuggling-migrants-land-sea-and-air>

9. Përsa i përket transportit, migrantët zgjedhin mjete të ndryshme transporti të ofruara nga kontrabanduesit. Metoda më e zakonshme përfshin udhëtimin me taksi ose përdorimin e furgonëve që lejojnë shumë migrantë të udhëtojnë së bashku. Mjete të tjera transporti përfshijnë përdorimin e makinave të marra me qira ose fshehjen në kamionë të tonazhit të rëndë edhe pa dijeninë e drejtuesve të këtyre të fundit.
10. Migrantët u paguajnë shuma të konsiderueshme parash kontrabanduesve për shërbimet e tyre, me pagesa që variojnë zakonisht nga 100 deri në 800 Euro për person, në varësi të ndihmës dhe shërbimit të kërkuar. Në përgjithësi, migrantët kanë raportuar se kanë paguar nga 5000 deri në 8000 Euro për të gjithë rrugën nga vendi i tyre i origjinës deri në Shqipëri apo vendet anëtare të BE. Në rast se migrantët nuk mund të paguajnë shumën e rënë dakord, ata grabiten prej kontrabanduesve, u merren sendet personale dhe lihen pas pa lejuar të ndjekin grupin.
11. Profili i kontrabanduesve: kryesisht kontrabanduesit kanë qenë shtetas shqiptarë, megjithatë ka patur një ndryshim të dukshëm me kalimin e kohës pasi janë shtuar rastet kur vetë migrantët janë përfshirë në kontrabandimin e migrantëve të tjerë. Si rezultat, profili i kontrabanduesve është zgjeruar duke përfshirë edhe individë nga Iraku, Afganistani, Siria, Algjeria dhe kombësi të tjera. Moshë mesatare e vëzhguar e këtyre kontrabanduesve është zakonisht midis 30 dhe 35 vjeç.
12. Vërehet se në Shqipëri kontrabandimi funksionon më shumë mbi baza individuale sesa si grup i organizuar. Roli kryesor i kontrabanduesve shqiptarë mbetet ai i koordinimit dhe transportimit.
13. Migrantët i gjejnë kontaktet e kontrabanduesve edhe përmes rrjeteve sociale, megjithatë rezulton se kontaktin kryesor me kontrabanduesit e mbajnë të afërmit e migrantëve në BE, të cilët lehtësojnë procesin e kalimit të kufirit dhe shpesh paguajnë për shërbimin.
14. Ka patur raste kur punonjës të veçantë të organeve të policisë janë përfshirë gjithashtu në dhënien e ndihmës ndaj migrantëve për kalimin e paligjshëm të kufirit. Nga intervistat e realizuara rezulton se disa pjesëtarë të policisë u ofrojnë ndihmë migrantëve duke shkëmbyer informacione për patrullat e policisë në segmente të veçanta rrugore dhe madje edhe duke shoqëruar migrantët duke përdorur automjetet e policisë për të lehtësuar procesin e kalimit të tyre kufitar.
15. Midis migrantëve ka pak të mitur të pashoqëruar. Vendet e origjinës së tyre përfshijnë Afganistanin, Somalinë, Sirinë, Irakun, Palestinën, Egjiptin. Sipas policisë, një numër i konsiderueshëm i migrantëve të cilët janë kategorizuar si të mitur dyshohet se janë mbi 18 vjeç, por për shkak të mungesës së të dhënave alternative dhe metodave të besueshme të identifikimit, autoritetet janë të detyruara të mbështeten në deklaratat e tyre se janë të mitur.
16. Shqipëria ka përfunduar zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Migracionit 2019-2022 dhe Planit të Veprimit, ndaj një prej objektivave të së ardhmes në fushën e migracionit është hartimi dhe zbatimi i një dokumenti strategjik të ri kombëtar dhe gjithëpërfshirës. Aktualisht ka nisur puna drejt finalizimit të Strategjisë së re Kombëtare për Migracionin për 2024-2030 me mbështetjen e IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin).
17. Aktorët kryesorë kombëtarë të ngarkuar me çështjet e migracionit dhe luftimin e kontrabandës së migrantëve janë: Ministria e Brendshme, Departamenti i Migracionit dhe Kufirit, Avokati i Popullit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Drejtësisë, Qendra për Ndalimin e të Huajve, Kareç (Qendra e Mbyllur); Qendra Kombëtare për Azilkërkues.
18. Kapacitetet dhe sfidat institucionale:
 - Policia e Kufirit dhe Migracionit ka patur përmirësime dhe avancime në kapacitetet e saj logjistike dhe strukturore, megjithatë sërish përballen me sfidat aktuale si: mungesa e pajisjeve të nevojshme për mbikëqyrjen e kufirit, si dhe në rastet ku pajisjet janë në dispozicion, ekziston nevoja për modernizimin e tyre për t'iu përgjigjur kërkesës për një monitorim më të mirë të kufirit. Gjithashtu, ambientet brenda institucioneve vartëse të policisë ku mund të mbahen migrantët përkohësisht për disa orë rezultuan të jenë në kushte jo të përshtatshme për qëndrimin e tyre.
 - Trajnimet dhe modulet e trajnimit të vazhdueshme janë të nevojshme për t'iu përgjigjur dinamikave të ndryshueshme të flukseve migratore si në vend, rajon dhe Bashkimin Evropian.

- Gjithashtu, ndërrimi i shpeshtë i stafit policor të kufirit, duhet të adresohet duke kryer trajnime të shpeshta dhe gjithëpërfshirëse për stafin e ri. Lëvizja dhe rotacioni i shpeshtë i stafit paraqet sfida për vazhdimësinë e proceseve dhe monitorimin efektiv të procedurave, si dhe ruajtjen e informacionit dhe kujtesës institucionale.
- Në strukturat shtetërore përgjegjëse për migracionin konstatohet mungesë e burimeve njerëzore si avokat, psikolog, mjek apo përkthyes. Në rastet kur shërbimet e mësipërme nevojiten, këto burime thirren në kuadër të bashkëpunimit me institucione të tjera. Ky proces mund të vonojë përgjigjen ndaj nevojave të menjëhershme të migrantëve pas kapjes, prandaj është e rëndësishme që këto institucione të zgjerojnë stafin dhe të përfshijnë role të tilla në organigramën e tyre.
- Nga monitorimi u vu re se mungon bashkëpunimi ndërinstytucional në trajtimin e duhur të rasteve të të miturve, veçanërisht të të miturve të pashoqëruar, të cilët janë një nga kategoritë më vulnerabël të migrantëve.
- Mungesa e tërësishme dhe cilësia e pamjaftueshme e standartizimit të të dhënave nga institucionet e ndryshme shtetërore: mbledhja e të dhënave, kategorizimi dhe përpunimi i tyre ka një rëndësi të madhe për të kuptuar tendencën e migracionit në vend. Përpjekjet e bazuara në të dhëna konkrete janë thelbësore për marrjen e masave efektive, hartimin e politikave të përshtatshme dhe adresimin e sfidave dhe çështjeve të reja që lidhen me migracionin.

1. Hyrje

Ky raport paraqet një përmbledhje gjithëpërfshirëse të gjetjeve që kanë rezultuar nga monitorimet e kryera nga anëtarët e Platformës Kombëtare për Parandalimin e Kontrabandimit dhe Mbrojtjen e Migrantëve të Kontrabanduar në Shqipëri, të drejtuar nga koordinatori kombëtar i nismës, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, (KShH), në kuadër të zbatimit të nismës *“Siguria për Qeniet Njerëzore dhe Kufijtë – Luftimi i Kontrabandimit të Migrantëve në Ballkanin Perëndimor”*.

Në bazë të përkufizimit të Kombeve të Bashkuara², “kontrabandimi i migrantëve” do të thotë shkaktimi për qëllim përfitimi financiar ose material, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i hyrjes në mënyrë të paligjshme në një Shtet Palë të një personi, në të cilin ai/ajo nuk është as shtetas e as banor i përhershëm.

Numri i migrantëve të parregullt të kapur në kufi ka ardhur vazhdimisht në rritje, veçanërisht pas fillimit të operacioneve të përbashkëta me Frontex pas hyrjes në fuqi më 1 maj 2019 të Marrëveshjes Statutore *“Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojes Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë, FRONTEX”* ratifikuar me ligjin nr.6/2019. Të dhënat e Frontex tregojnë se shumica e rasteve të raportuara të migrantëve të parregullt në kufijtë e jashtëm të BE-së kanë ardhur në rajonin e Ballkanit Perëndimor, kryesisht nga meshkuj të moshës 18-34 vjeç.

Pavarësisht masave të marra për të luftuar migracionin e parregullt, ky fenomen është rritur dhe mbetet i pranishëm në Shqipëri, çka e tregojnë qartë edhe të dhënat statistikore të paraqitura nga raportet kombëtare dhe ndërkombëtare. Migrantët nga vendet e treta kryesisht hyjnë në Turqi dhe më pas kalojnë në Greqi dhe përmes vendeve të Ballkanit Perëndimor synojnë vendet e Bashkimit Evropian (BE) dhe kryesisht vendet në veri të BE-së. Një nga drejtimet e lëvizjes së tyre është rruga Shqipëri-Mali i Zi-Kroaci dhe më pas vendet e BE-së. Rruga e migrantëve të parregullt që kalon nëpër kufirin greko-shqiptar njihet si Korridori Perëndimor.

Në shumicën e rasteve, migrantët e parregullt janë në një situatë vulnerabiliteti për shkak të: situatës në vendet e tyre të origjinës nga të cilat janë larguar, ndodhjes në kushte pashtetësie, kushteve të vështira të jetesës dhe udhëtimit (p.sh. duke përjetuar situata shfrytëzimi apo abuzimi para apo gjatë udhëtimit).

Migrantët që mbërrijnë në Shqipëri në mënyrë të parregullt janë kryesisht persona që vijnë nga vende që “prodhojnë” refugjatë dhe azilkërkues. Analiza e tendencave të ndryshme dhe në rritje të lëvizjeve të popullsisë në vendet fqinje të Shqipërisë dikton nevojën për të forcuar kapacitetin e vendit tonë për të pritur një numër më të madh të ardhurish në territorin e tij. Në këtë kontekst, mbetet thelbësore të ndiqet nga afër jo vetëm dinamika e lëvizjeve migratore për arsye të ndryshme, por edhe shenjat e hershme paralajmëruese për rritjen e numrit të migrantëve.

Shënim mbi konfidencialitetin:

Të dhënat statistikore dhe metodologjitë e përshkruara në këtë raport janë informacione të disponueshme dhe aksesueshme për publikun. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se të dhënat specifike të lidhura me të dhënat personale, si emrat, datat e hyrjes, të dhënat e ndalimit dhe informacione të tjera të lidhura me migrantët, konsiderohen konfidenciale dhe nuk janë ndarë në përmbajtjen e këtij raporti.

2 Organizata e Kombeve të Bashkuara, Protokollin kundër kontrabandimit të migrantëve në rrugë tokësore, ajrore dhe detare, shtesë e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar) <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/protocol-against-smuggling-migrants-land-sea-and-air>

2. Terminologjia

1. **"I huaj"** është çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar.
2. **"Qëndrim i parregullt"** është prania në territorin e Republikës së Shqipërisë të një të huaji, i cili nuk plotëson, ose nuk plotëson më kushtet për hyrje, qëndrim ose banim në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. **"Kërkesë për azil"** është çdo deklaratë e shprehur nga i huaji, përmes së cilës ai kërkon mbrojtje apo mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin për azilin në Republikën e Shqipërisë.
4. **"Refugjat"** është çdo person, i cilësuar i tillë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë.
5. **"I mitur i pashoqëruar"** është i mituri i huaj, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë i pashoqëruar nga një person madhor përgjegjës, sipas ligjit, për sa kohë që nuk merret efektivisht në përkujdesje prej tij, ose i mituri që lihet i pashoqëruar, pas hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë.
6. **"Autoritete shtetërore përgjegjëse"** janë organet shtetërore, si dhe çdo strukturë tjetër në varësi të tyre, të cilat ushtrojnë funksione në fushën e legjislacionit për të huajt, sipas kompetencave që u njeh ky ligj ose aktet nënligjore në zbatim të tij.
7. **"Vendimi i kthimit"** është një akt administrativ ose vendim gjyqësor i autoriteteve shqiptare, i cili deklaron se qëndrimi i një të huaji në territorin e Republikës së Shqipërisë është i paligjshëm dhe që vendos ose deklaron detyrimin për kthimin e të huajit.

3. Metodologjia

Monitorimi i situatës për parandalimin e kontrabandimit dhe migrantëve të kontrabanduar në Shqipëri u krye duke marrë në konsideratë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të Republikës së Shqipërisë, si dhe standardet ndërkombëtare për mbledhjen e informacionit. Metodologjia e monitorimit të KSHH-së synonte mbledhjen e të dhënave në lidhje me gjendjen aktuale të kontrabandimit të migrantëve në Shqipëri nëpërmjet mjeteve të ndryshme të përdorura për mbledhjen e të dhënave.

Për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të tilla, KSHH dhe OSHC-të anëtare në Platformën Kombëtare përdorën një sërë instrumentesh sasiore dhe cilësore, të kombinuara, si më poshtë:

1. Shkresa zyrtare

Fillimisht, për hartimin e këtij raporti monitorues janë marrë në konsideratë të dhënat e mbledhura nga korrespondenca zyrtare e shkëmbyer me institucionet përkatëse që ushtrojnë funksione në fushat që mbulon legjislacioni për të huajt, sipas kompetencave të njohura nga ky ligj apo akte nënligjore për zbatimin e tij. Informacioni i kërkuar nga këto institucione ka synuar në sigurimin e të dhënave statistikore, duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe duke mos cënuar të dhënat personale të migrantëve potencialisht të përfshirë.

2. Vizita monitoruese

Anëtarët e Platformës Kombëtare kanë kryer 13 vizita monitoruese në pikat kryesore të kalimit të kufirit³ me numrin më të madh të kalimeve të parregullta të identifikuara, për të vëzhguar aktivitetet që lidhen me kontrabandimin e migrantëve, operacionet kufitare, infrastrukturën, sjelljen e autoriteteve kufitare etj. Gjithashtu, Platforma u angazhua në kryerjen e vizitave monitoruese pranë Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit në Babrru dhe në Qendrën e Mbyllur Kareç.

3. Intervista

Anëtarët e Platformës Kombëtare zhvilluan intervista gjysmë të strukturuar me autoritetet përgjegjëse për kontrabandimin e migrantëve, duke përfshirë përfaqësuesit e autoriteteve, personelin e sigurisë, oficerët e policisë së kufirit si dhe vetë migrantët kur ishin të pranishëm gjatë monitorimit. Këto intervista u fokusuan në të kuptuarit e sfidave dhe çështjeve që prekin kontrabandimin e migrantëve, praktikën, rrugët, aktorët e përfshirë, mënyrën e funksionimit etj.

4. Desk research (hulumtimi)

KSHH dhe anëtarët e Platformës Kombëtare, analizuan të dhënat e mbledhura gjatë procesit të kërkimit, duke përfshirë kërkimin *online*, vizitat monitoruese dhe intervistat, duke përdorur një sërë metodash cilësore dhe sasiore për të identifikuar modelet, tendencat dhe temat që lidhen me pyetjet e kërkimit.

Raporti nuk është shterues, por ai paraqet një përmbledhje mbi fenomenin e kontrabandimit të migrantëve dhe çështjeve e sfidave që lidhen me këtë fenomen në territorin e Shqipërisë. Raporti përbëhet nga tre kapituj kryesorë. Kapitulli i parë analizon kapacitetet e autoriteteve institucionale për të luftuar kontrabandimin e migrantëve. Kapitulli i dytë fokusohet në kontrabandimin e migrantëve në praktikë, ndërsa kapitulli i tretë paraqet gjetjet më të rëndësishme të këtij raporti studimor dhe rekomandimet drejtuar autoriteteve për të kontribuar në përmirësimin e parandalimit dhe mbrojtjes së migrantëve nga kontrabandimi.

Kufizimet e studimit:

Ndërsa studimi arriti të realizojë të gjitha objektivat e përshkruara në metodologjinë e tij, ai ka kufizime në lidhje me informacionin gjithëpërfshirës të disponueshëm. Gjatë zhvillimit të studimit, u hasën kufizime për shkak të mungesës së migrantëve të pranishëm gjatë misioneve monitoruese, gjë që pengonte vlerësimin e tendencave dhe modeleve në aktivitetet kontrabanduese. Për më tepër, përfshirja e grave migrante të intervistuar nuk përputhej plotësisht me kategorizimin e përgjithshëm, pasi u intervistuan vetëm burra të rritur, ndërsa gratë, të miturit dhe personat me aftësi të kufizuara ishte e pamundur të përfshiheshin në intervista.

3 Annex II: Lista e pikave të kalimit të kufirit dhe institucioneve të monitoruara.

4. Kapacitetet institucionale në menaxhimin e migracionit dhe luftimin e kontrabandimit të migrantëve

Kontrabandimi i migrantëve përfshihet në kapitullin 24 të *acquis* të BE-së⁴, i cili fokusohet në fushat e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë. Ai është i lidhur ngushtë me aspekte të ndryshme të mbuluara nga ky kapitull, si migrimi i parregullt, menaxhimi i kufijve, rregulloret e zonës Shengen, politikat e vizave në BE, lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe adresimi i krimit të organizuar. Si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE, veçanërisht gjatë fazës fillestare të negociatave që përfshin Grupin e parë të Kapitujve dhe Kapitullin 24, Shqipëria ka shtuar përpjekjet e saj për zbatimin e reformave të nevojshme dhe rritjen e kapaciteteve institucionale.

Anëtarësimi në BE shërben si një orientim strategjik për Shqipërinë sa i takon miratimit dhe zbatimit të politikave në përputhje me kriteret dhe standardet e BE-së. Si pjesë e procesit të negociatave, legjislacioni kombëtar i nënshtrohet një analize të plotë, të njohur si procesi i shqyrtimit (*screening*), për të vlerësuar përputhshmërinë e tij me ligjet e BE-së. Gjithashtu, vlerësohen edhe kapacitetet institucionale të vendit për të siguruar zbatimin efektiv të këtij legjislacioni.

Kontrabandimi i migrantëve është i lidhur drejtpërdrejt me menaxhimin gjithëpërfshirës të kufijve, i cili ka një rëndësi të dyfishtë në kontekstin e anëtarësimit në BE. Së pari, ai shërben si një parakusht që duhet të plotësohet për të çuar përpara procesin e integritimit. Së dyti, duke pasur parasysh se territori i Republikës së Shqipërisë ndodhet pranë kufijve të jashtëm të Bashkimit Evropian, menaxhimi i integruar i kufijve merr një rëndësi të shtuar si në aspektin e respektimit të politikave dhe standardeve të BE-së ashtu dhe për shkak të implikimeve gjeostrategjike që lidhen me të.

Së fundmi, Shqipëria ka përfunduar zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Migracionit 2019-2022 dhe Planit të Veprimit, ndaj një ndër objektivat e së ardhmes në fushën e migracionit është hartimi dhe zbatimi i një dokumenti strategjik të ri kombëtar dhe gjithëpërfshirës. Aktualisht ka nisur puna drejt finalizimit të Strategjisë së re Kombëtare për Migracionin për 2024-2030 me mbështetjen e IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin). Strategjia e re e migracionit do të synojë:

- Përmirësimin e mëtejshëm të mekanizmave të ngritur për koordinimin e qeverisjes së migracionit dhe menaxhimin e flukseve migratore që kanë prekur rajonin dhe vendin tonë dhe që pritet të vazhdojnë në periudhën në vijim.
- Përputhshmërinë e objektivave me dispozitat e Komunikatës së Komisionit për Parlamentin Evropian dhe Këshillin mbi Strategjinë e BE-së për kthimin vullnetar dhe riintegrimin, datë 27.04.2021 – EUR-Lex – 52021DC0120⁵.
- Zhvillimin dhe zbatimin e një politike të qeverisjes së migracionit të përafuar me Paktin Global për Migracionin (GCM), përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe shoqërisë.
- Zhvillimin dhe zbatimin e një politike të qeverisjes së migracionit të harmonizuar me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2021-2030.

Së fundmi, Ministria e Punëve të Brendshme ka zhvilluar një tryezë të rrumbullakët fokusuar në zbatimin e Strategjisë së mëparshme Kombëtare të Migracionit dhe Planit të Veprimit 2019-2022, si dhe vizionin dhe objektivat specifike të Strategjisë së re 2024-2030. Për strategjinë e re, përfaqësuesit e Grupit Ndërinstitucional të Punës, do të përfshijnë ndër të tjera: nevojën për rishikim të bazës ligjore për migracionin e punës; shërbimet sociale/integruese të të huajve në Republikën e Shqipërisë; të miturit e pashoqëruar; riintegrimin e migrantëve të kthyer; mekanizmin koordinues me pushtetin vendor. Strategjia kombëtare aktuale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka parashikuar kompetenca dhe përgjegjësi konkrete për aktorët kombëtarë përgjegjës për migracionin. Objektivi i dytë i Strategjisë Kombëtare i kushtohet "Garantimit të migracionit të sigurt dhe të rregullt nga, përmes dhe drejt Shqipërisë" me 4 fusha kryesore si më poshtë:

4 Ligjet qeverisëse të Bashkimit Evropian.

5 Communication of the Commission to the European Parliament and the Council on the EU Strategy for voluntary return and reintegration, dated 27.04.2021 – EUR-Lex – 52021DC0120.

- Trajtimi në mënyrë të efektshme i lëvizjeve të parregullta në kufijtë e shtetit dhe në brendësi të territorit të Shqipërisë;
- Përmirësimi i efektshmërisë së mekanizmave të kthimit në vendin e origjinës për shtetasit e huaj;
- Reagimi me efikasitet ndaj migracionit të parregullt të shtetasve shqiptarë në vendet anëtare të BE-së;
- Menaxhimi i flukseve të përziera.

4.1. Aktorët kyç kombëtar përgjegjës për migracionin dhe luftimin e kontrabandimit të migrantëve

Ministria e Brendshme⁶

Ministria e Brendshme luan një rol vendimtar në menaxhimin e sistemit të migracionit dhe ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në Shqipëri. Ministria është përgjegjëse për formulimin e politikave të nevojshme që synojnë harmonizimin me legjislacionin dhe politikën e Bashkimit Evropian. Në kuadër të procesit të integritimit evropian, veçanërisht në kontekstin e negociatave për Kapitullin 24 (Drejtësia, Siguria, Liria), Ministria e Punëve të Brendshme luan një rol kyç. Zëvendësiministri i Brendshëm shërben si kryenegociator për këtë kapitull, duke përfshirë çështje të ndryshme të ndërlidhura si migracioni i parregullt, kontrabandimi i migrantëve, trafikimi i qenieve njerëzore dhe lufta kundër krimit të organizuar. Për të rritur bashkëpunimin ndërkufitar, Shqipëria ka lidhur marrëveshje dhe protokolle me vendet fqinje, duke përfshirë Republikën e Kosovës, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë. Këto marrëveshje synojnë krijimin e Pikave të Përbashkëta të Kalimit të Kufirit dhe lehtësimin e aktiviteteve të përbashkëta të kontrollit kufitar. Për më tepër, ato lehtësojnë krijimin dhe funksionalizimin e Qendrave të Përbashkëta të Bashkëpunimit Policor, kontribuojnë në rregullimin e trafikut lokal dhe ndër të tjera mundësojnë ndjekjen ndërkufitare të çështjeve.

Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit ka parashikuar gjithashtu masa konkrete që Ministria duhet të ndër marrë për një menaxhim më të mirë të migracionit dhe migrantëve që vijnë drejt dhe kalojnë përmes Shqipërisë. Këto masa përfshijnë, por nuk kufizohen në: hartimin e një plani emergjence për Shqipërinë për të menaxhuar flukset e përziera, duke marrë në konsideratë situatën vulnerabël të popullatave në lëvizje (si të miturit e pashoqëruar, viktimat e trafikimit, azilkërkuesit, individët me aftësi të kufizuara, etj.), dhe përditësimin e tij në mënyrë të rregullt; ndërmarrjen e fushatave informuese për të drejtat e migrantëve dhe ofrimin e informacionit në gjuhën kryesore të përdorur prej tyre mbi procedurat dhe shërbimet e ofruara nga aktorë të ndryshëm në Shqipëri; dhe forcimin e kapaciteteve të gjyqësorit dhe agjencive të zbatimit të ligjit (gjyqtarët, prokurorët, policia, inspektorët e punës) për të zbuluar dhe ndjekur siç duhet rastet e shkeljes së të drejtave të migrantëve, çka është e rëndësishme për të adresuar sfidat e lidhura me kontrabandimin.

Organet kryesore përgjegjëse për zbatimin e politikave të migracionit nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Brendshme janë Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Antitrafikut dhe Migracionit në Ministrinë e Brendshme.

Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit

Departamenti për Kufirin dhe Migracionin organizohet në nivel qendror dhe vendor, dhe është përgjegjës për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, si dhe trajtimin e të huajve në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në nivel qendror, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin është i organizuar në drejtori të përgjithshme, ndërsa në nivel vendor ka drejtori vendore të policisë.

Drejtorja Vendore e Kufirit dhe Migracionit, një institucion brenda Policisë së Shtetit, është përgjegjëse për garantimin e sigurisë së kufirit shtetëror brenda zonës së përcaktuar. Kjo drejtori, në përputhje me ligjin, mbikëqyr gjithashtu trajtimin e duhur të të huajve në Shqipëri dhe lufton në mënyrë aktive trafikimin e paligjshëm, kontrabandimin dhe çdo veprimtari tjetër kriminale që kryhet në kufi.

⁶ Në përgjithësi dhe Drejtoria e Antitrafikut dhe Migracionit në veçanti.

Policia e Kufirit dhe Migracionit përdor mjete specifike teknike dhe teknologjike, sisteme të automatizuara dhe elektronike për verifikimin e identitetit, për të zbatuar përgjegjësitë e saj, me qëllim parandalimin e rasteve të personave të cilët shmangin kontrollin në kufi apo kalojnë kufirin në mënyrë të parregullt ose për zbulimin e veprave penale.

Në bazë të ligjit nr. 72/2016, "Për kontrollin kufitar", kompetencat e Policisë së Kufirit dhe Migracionit ndahen në dy kategori: ato që i përkasin kontrollit në kufi (neni 6) dhe ato të zbatueshme në brendësi të territorit të Shqipërisë (neni 7).

Në bazë të nenit 6, kompetencat e Policisë së Kufirit dhe Migracionit në kufi përfshijnë kryesisht kryerjen e kontrollit kufitar dhe verifikimin e identitetit të personave. Rojat kufitare, për arsye të verifikimit kufitar, kanë të drejtën të refuzojnë hyrjen dhe daljen e një të huaji, në përputhje me parashikimet e legjislationit.

Neni 7 i ligjit nr. 72/2016 përcakton kompetencat e Policisë së Kufirit dhe Migracionit në brendësi të territorit shqiptar. Këto kompetenca përqendrohen në parandalimin, zbulimin dhe luftimin e krimit ndërkufitar, duke përfshirë hyrjen, kalimin ose qëndrimin e paligjshëm të të huajve. Kompetencat në brendësi të territorit shqiptar përfshijnë marrjen e masave të duhura për identifikimin dhe kapjen e të huajve që qëndrojnë ose kalojnë tranzit në mënyrë të parregullt në territorin e Shqipërisë, kryerjen e intervistave dhe verifikimeve të individëve, sendeve ose mjeteve të transportit, si dhe ndërmarrjen e veprimeve hetimore dhe procedurale në rastet e veprave penale që lidhen me kufirin që bie nën juridiksionin e tyre.

Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit ka parashikuar gjithashtu kompetenca specifike për Departamentin për Kufirin dhe Migracionin sa i takon trajtimin të migrantëve që kalojnë përmes dhe drejt Shqipërisë. Disa nga këto kompetenca përfshijnë: përmirësimin e menaxhimit të të dhënave për migrantët dhe krijimin e një sistemi të përbashkët të menaxhimit ndërinstitucional të informacionit; angazhimin për modernizimin e pajisjeve dhe infrastrukturës së menaxhimit të kufirit për të forcuar mbikëqyrjen kufitare; përmirësimin e infrastrukturës në pikat e kalimit të kufirit për të përmbushur nevojat specifike të migrantëve (fëmijë, të moshuar, persona me aftësi të kufizuara, etj.); forcimin e kapaciteteve të stafit të menaxhimit të kufirit duke rritur normat e angazhimeve në trajnime dhe duke siguruar respektimin e praktikave të mira dhe standardeve evropiane për menaxhimin e kufirit dhe migracionit dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve; rritjen e kapaciteteve të stafit për të identifikuar kategoritë vulnerabël në rastet e flukseve të përziera si dhe sigurimin e së drejtës për një strehim të sigurt dhe të denjë për popullatat në lëvizje në kufi dhe brenda territorit, veçanërisht për kategoritë vulnerabël si të miturit e pashoqëruar.

Ministria e Drejtësisë

Sipas Strategjisë Kombëtare për Migracionin, Ministria e Drejtësisë ka disa përgjegjësi për menaxhimin e migracionit. Një nga detyrat kryesore të kësaj ministrie është t'u ofrojnë migrantëve të parregullt asistencë ligjore falas dhe informacion në gjuhën e tyre sa i takon procedurave të migrimit dhe të drejtave që migrantët kanë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Për të siguruar trajtimin e duhur shëndetësor dhe mbrojtjen sociale të migrantëve të parregullt që vijnë në Shqipëri, Strategjia Kombëtare ka parashikuar gjithashtu kompetenca specifike për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke përfshirë:

- Sigurimin që kuadri ligjor dhe institucional ofron strehim të përshtatshëm për të miturit e pashoqëruar që kalojnë kufirin ilegalisht;
- Identifikimin dhe adresimin e pengesave dhe sfidave sa i takon aksesit në shërbimet publike nga migrantët e parregullt; në veçanti, rivlerësimin e mundësisë për të ofruar arsim fillor për fëmijët e migrantëve të parregullt dhe kujdes shëndetësor bazë për të huajt që nuk kanë status të caktuar;
- Trajnimin e personelit mjekësor për të përmirësuar shërbimet ndaj të huajve në vend duke kuptuar më mirë rreziqet përkatëse shëndetësore dhe sociale, si dhe ndikimin që kultura e tyre mund të ketë në shëndetin dhe trajtimin e sëmundjeve.

Avokati i Popullit

Si pjesë e zyrës së Avokatit të Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë së Kufirit dhe Migracionit dhe FRONTEX ka vijuar të monitorojë vazhdimisht riatdhesimet vullnetare dhe të detyruara të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe zonës Shengen. Nga ana tjetër, si pjesë e mandatit të tij për monitorimin e respektimit të të drejtave të njeriut, MKPT kryen inspektime për të vlerësuar nivelin e zbatimit e respektimit të këtyre të drejtave në institucionet që mund të akomodojnë migrantë të parregullt si më poshtë:

- Qendra e Mbyllur e të Huajve, Kareç;
- Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit (QKPA);
- Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit.

Avokati i Popullit gjithashtu kryen misione monitorimi edhe në pikat ndërkufitare, por për shkak të kapaciteteve të kufizuara njerëzore dhe financiare, institucioni e ka bërë këtë përmes zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me UNHCR-në në projekte të përbashkëta dhe ka monitoruar disa pika ndërkufitare në zonat jugore dhe juglindore të vendit.

Qendra e Mbyllur e të Huajve, Kareç

Qendra e Mbyllur e të Huajve u krijua fillimisht me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1083, datë 28.10.2009 *"Për ngritjen e Qendrës së Mbyllur dhe për miratimin e Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të saj"*. Qëllimi i qendrës është strehimi i të huajve të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndaj të cilëve është marrë një masë ndalimi në përputhje me legjislacionin në fuqi, Qendra është pjesë e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe financohet nga buxheti i shtetit. Qendra e Mbyllur e Pritjes është një objekt administrativ me nivel sigurie dhe izolimi të përcaktuar, ku mbahen vetëm të huajt që i nënshtrohen urdhrat të dëbimit nga Republika e Shqipërisë⁷. Gjatë misionit monitorues në Qendër kanë qenë të pranishëm 10 emigrantë të huaj.

Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit, Babrru

Qendra Kombëtare Pritëse e Azilkërkuesve, me vendndodhje në Babrru, Tiranë, është e vetmja qendër e caktuar për strehimin e azilkërkuesve në Shqipëri. Kompetencat kryesore të Qendrës parashikohen në Ligjin nr. 10/2021 *"Për azilin në Republikën e Shqipërisë"*. Azilkërkuesi, pas paraqitjes së kërkesës për azil, vendoset në Qendrën Pritëse të Azilkërkuesve. Edhe personi të cilit i është refuzuar kërkesa për azil qëndron në këtë Qendër deri në përfundimin e procedurave të ankimimit ose mbarimit të afateve për ankim. Qendra duhet të sigurojë kushte minimale të jetesës, duke përfshirë: a) akomodimin; b) ushqimin; c) sigurimin shëndetësor; ç) kushtet minimale të higjienës. Programet mësimore dhe edukuese, si dhe këshillimi juridik falas, ofrohen në bashkëpunim me subjekte të tjera, private ose publike, vendase ose të huaja, në përputhje me të drejtat e azilkërkuesve dhe refugjatëve. Deri në mars të vitit 2023, në këtë qendër ishin akomoduar 19 emigrantë. Kombësitë kryesore të emigrantëve të pranishëm gjatë vizitës monitoruese ishin Ukraina, Afganistani, Iraku dhe Rusia. Në qendër ishin të strehuar edhe 10 të mitur, njëri prej të cilëve ishte i mitur i pashoqëruar.

7 Neni 114, Ligji nr. 79/2021 'Për të huajt'.

4.2. Kapacitetet dhe sfidat institucionale

Kuadri ligjor për të huajt dhe proceset e azilit është përditësuar, megjithatë, duhet të vijojë përrputhjen me rregulloret e reja të BE-së dhe të arrijë një nivel më të lartë të harmonizimit duke marrë në konsideratë zhvillimet e fundit, si dhe veçanërisht zbatimin e duhur të legjislacionit dytësor. Nga ana tjetër, nevojitet që këto përditësime të kuadrit ligjor të reflektohen proporcionalisht në përmirësime të mëtejshme në aspektin e kapaciteteve logjistike dhe strukturore.

Në Progres Raportin Vjetor të Komisionit Evropian për Shqipërinë të publikuar në tetor 2022, BE ka vlerësuar përpjekjet e Shqipërisë për të përmbushur rekomandimet e Komisionit Evropian në lidhje me Kapitullin 24 dhe më konkretisht në fushat që prekin fenomenin e kontrabandimit të migrantëve. Gjithsesi, kontrabandimi i migrantëve mbetet një çështje sfiduese për autoritetet shqiptare. Kjo vjen si pasojë e mjeteve dhe mekanizmave teknologjikë të nevojshme për mbikëqyrjen e kufirit, si dhe burimeve njerëzore të dedikuara dhe rritjes së kapaciteteve të burimeve ekzistuese. Prandaj, Komisioni Evropian rekomandon që aftësitë hetimore të Policisë së Shtetit dhe më konkretisht të Departamentit për Kufirin dhe Migracionin të përmirësohen dhe forcohen, me qëllim identifikimin dhe parandalimin e rasteve të kontrabandimit të migrantëve. Gjithashtu, një tjetër prej rekomandimeve të sugjeruara nga BE është vijimi i luftës kundër krimit të organizuar, ku bashkëpunimi me shtetet anëtare dhe agjencitë e BE-së duhet të forcohet duke përfshirë *Europol*-in dhe *Eurojust*-in. Sipas Planit Kombëtar të Integritimit në Bashkimin Evropian për periudhën 2023-2025, ka disa fusha ku autoritetet shqiptare dhe, më konkretisht, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit pranë Policisë së Shtetit kanë bërë progres në vitet e fundit duke marrë parasysh rekomandimet e dhëna për Shqipërinë në kuadër të procesit të integritimit evropian, si dhe zhvillimet lidhur me menaxhimin e migracionit të parregullt në vend, si dhe rastet në rritje të kontrabandimit të emigrantëve në Shqipëri.

Kështu, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit ka dëshmuar përmirësime në kapacitetet e saj logjistike dhe strukturore. Disa faktorë që kanë kontribuar në këto përmirësime janë ndarja e informacionit, miratimi i praktikave më të mira nga vendet e BE-së dhe respektimi i standardeve të zonës Shengen. Gjithashtu, trajnimet dhe përpjekjet bashkëpunuese me shtetet anëtare dhe agjencitë e BE-së si Frontex, pjesëmarrja në operacionet ndërkombëtare dhe ndihma financiare për zhvillimin e aftësive logjistike dhe profesionale kanë luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm në këtë progres.

Megjithatë, siç thuhet në Raportin e Progresit të KE 2022⁸ dhe siç është vërejtur gjatë vizitave monitoruese në disa pika kufitare dhe komisariate, oficerët e Policisë së Kufirit dhe Migracionit duhet të rrisin kapacitetet e tyre në shumë drejtime. Së pari, është e nevojshme që stafi në kufi të ketë aftësitë e nevojshme për të identifikuar migrantët dhe refugjatët me nevoja specifike dhe për t'u ofruar atyre ndihmën e nevojshme. Aktualisht, identifikimi i viktimave të mundshme është i pamjaftueshëm, veçanërisht për fëmijët e pashoqëruar.

Gjithashtu, u vu re se institucioneve u mungojnë pajisjet e nevojshme për mbikëqyrjen e kufirit si dhe aty ku ka pajisje është i nevojshëm modernizimi i tyre për t'iu përgjigjur kërkesës për monitorimin e duhur të kufirit. Mjetet e policisë që nevojiten për transportin e migrantëve në institucionet përkatëse sipas nevojës (strehim, qendra pritjeje, spitale etj.) ose mungojnë ose janë në kushte të këqija. Prandaj, ka raste kur oficerët e policisë përdorin makinat e tyre personale për të transportuar migrantët në varësi të rrethanave. Gjithashtu, ambientet brenda institucioneve të policisë ku mbahen migrantët përkohësisht për disa orë janë vërejtur të jenë në kushte jo të përshtatshme. Në vijim, dhe qendrat e pritjes, ku migrantët mbahen për periudha të gjata, shfaqin gjithaq papërshtatshmëri në ambiente. Kështu, gjatë misionit monitorues në Kareç, u konstatua se disa ambiente të qendrës së pritjes, si dhoma e intervistave/takimeve, dhomat e izolimit dhe korridoret, kishin lagështi dhe ishin në kushte të këqija.

Për sa i përket burimeve njerëzore dhe kapaciteteve, janë kryer trajnime të ndryshme dhe operacione të përbashkëta për oficerët e kufirit. Megjithatë, nevojiten module dhe struktura të përhershme trajnime për t'iu përgjigjur dinamikës në ndryshim të flukseve migratore në vend, rajon dhe BE. Gjithashtu, ndërrimi i shpeshtë i stafit dhe oficerëve të kufirit duhet të adresohet duke kryer trajnime të rregullta dhe gjithëpërfshirëse për stafin e ri sa i takon dispozitave ligjore, procedurave që duhet të kryhen për kategoritë e ndryshme të të huajve që vijnë në Shqipëri si dhe të drejtave të migrantëve, veçanërisht atyre në kushte vulnerabël. Siç theksohet në raportin e progresit të BE-së, lëvizja dhe rotacioni i shpeshtë i stafit paraqet sfida për vazhdimësinë e proceseve dhe monitorimin efektiv të procedurave, si dhe ruajtjen e kujtesës institucionale. Për më tepër, lëvizjet e shpeshta të stafit i pengojnë individët të specializohen në një fushë specifike dhe të japin kontribute të konsiderueshme për shkak të riemërimeve të vazhdueshme.

8 [*Albania Report 2022.pdf \(europa.eu\)](#).

Mungesa e burimeve njerëzore për t'iu përgjigjur nevojave gjatë kapjes së migrantëve të parregullt mbetet gjithashtu sfiduese⁹. Në shumë pika të kalimit të kufirit dhe komisariateve të policisë mungon personeli si avokat, psikolog, mjek apo përkthyes. Sa herë që shërbimet e tyre nevojiten, ata thirren në kuadër të bashkëpunimit me institucione të tjera. Ky proces mund të vonojë përgjigjen e menjëhershme ndaj nevojave të migrantëve pas kapjes, prandaj është e rëndësishme që këto institucione të zgjerojnë stafin dhe të përfshijnë role të tilla në organigramën e tyre.

Përpjekjet e autoriteteve shqiptare kundër trafikimit duhet të rriten, veçanërisht duke forcuar sistemin e mbrojtjes së fëmijëve. Nga monitorimi u vu re se mungon bashkëpunimi ndërinstitucional në trajtimin e duhur të rasteve të të miturve, veçanërisht të të miturve të pashoqëruar, të cilët janë një nga kategoritë më vulnerabël të migrantëve.

Përsa i përket kategorive të tjera të migrantëve, menaxhimi bëhet veçanërisht sfidues për shkak të mungesës së të dhënave, cilësisë së tyre dhe mungesës së standardizimit të të dhënave nga institucionet e ndryshme shtetërore. Mbledhja e të dhënave, kategorizimi dhe përpunimi i tyre ka një rëndësi të veçantë për të kuptuar migracionin në vend. Përpjekjet e ndërmarra të bazuara në të dhëna janë thelbësore për marrjen e masave efektive, hartimin e politikave të përshtatshme dhe adresimin e sfidave dhe çështjeve të reja që lidhen me migracionin.

Në Shqipëri, nuk ekziston një sistem monitorimi apo autoritet i specializuar për të mbikëqyrur dhe vlerësuar procedurat për trajtimin e të huajve, me fokus të veçantë ndaj rasteve vulnerabël si migrantët e parregullt, migrantët e kontrabanduar, azilkërkuesit ose/dhe viktimat e mundshme të trafikimit. Megjithatë strukturat si Avokati i Popullit apo Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zbatojnë kompetencat e tyre në lidhje me rastet e shkeljes së të drejtave dhe diskriminimit, vlerësohet se do të ishte më efektive të ketë një autoritet apo strukturë më të specializuar për trajtimin, monitorimin dhe vlerësimin e këtyre rasteve.

Në përputhje me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1009, datë 24.08.2022, është ngritur një grup pune pranë Departamentit për Kufirin dhe Migracionin. Qëllimi i këtij grupi është të hartojë një Strukturë Hetimi që do të rrisë aftësitë hetuese të departamentit, veçanërisht në zbulimin e rasteve që lidhen me kontrabandimin dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Për të adresuar në mënyrë efektive çdo rast, është e nevojshme të investohet në ngritjen e kapaciteteve, trajnimin dhe përdorimin e teknikave të avancuara dhe praktikave më të mira. Vlen të theksohet se ka pasur zhvillime pozitive në bashkëpunimin kufitar me vendet fqinje, vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe agjencitë përkatëse, megjithatë duke pasur parasysh natyrën dinamike dhe komplekse të rasteve të kontrabandimit të migrantëve dhe rritjen e rasteve të tilla në Shqipëri, është thelbësore të zgjerohet dhe konkretizohet më tej ky bashkëpunim. Kjo mund të arrihet përmes kryerjes së operacioneve të përbashkëta, si dhe zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit për të rritur kontrollin territorial dhe parandalimin dhe luftimin e krimit ndërkufitar.

Gjithashtu, është me rëndësi të theksohet rëndësia e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për menaxhimin e migracionit në mënyrë që të përmirësohet parandalimi dhe identifikimi i kontrabandimit të migrantëve. Aktualisht, këto institucione përkatëse shpesh e kufizojnë veten në përmbushjen e detyrimeve dhe roleve të tyre pa u koordinuar në mënyrë aktive me institucionet e tjera që mund të përfshihen në faza të tjera të trajtimit të rastit. Për të garantuar zbatimin efikas të masave specifike, është e domosdoshme të krijohet një sistem i unifikuar dhe koheziv i menaxhimit të migracionit, ku të gjithë palët e interesuara të punojnë së bashku si një entitet i unifikuar, duke përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

Për të rritur bashkëpunimin dhe përpjekjet e bashkërenduara, është thelbësore gjithashtu të nxiten partneritete më të ngushta dhe masa bashkëpunuese me vendet fqinje dhe kufitare si Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Greqia. Gjithashtu, është thelbësore të forcohet bashkëpunimi me Frontex, Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare. Zbatimi i marrëveshjeve dhe protokolleve të ndryshme sa i takon bashkëpunimit kufitar me vendet fqinje çon në një rritje të operacioneve të përbashkëta, patrullimeve dhe krijimit të strukturave bashkëpunuese përgjatë kufijve të përbashkët të këtyre shteteve. Vlen për t'u theksuar se shteti shqiptar ishte i pari shtet në Ballkanin Perëndimor i cili firmosi marrëveshjen e bashkëpunimit me Frontex në vitin 2019, duke formuar misionin e parë të përbashkët të Frontex me një shtet jo anëtar të BE, duke krijuar kështu një bashkëpunim të mirë mes institucioneve dhe autoritetit evropian në kryerjen e operacioneve tokësore dhe detare ndër vite, me qëllimin përfundimtar parandalimin dhe kapjen e shtetasve të huaj të përfshirë në emigracionin e paligjshëm.

⁹ Sipas raportit të Komisionit European, numri total i punonjësve të Departamentit të Policisë dhe Migracionit është 1,663 punonjës.

5. Kontrabandimi i migrantëve – vështrim nga praktika në Shqipëri

Ashtu si vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, edhe Shqipëria është prekur nga flukse të ndryshme të lëvizjes së migrantëve dhe refugjatëve. Shqipëria ka qenë kryesisht një vend tranziti për migrantët të cilët tentojnë të shkojnë në vendet e Bashkimit Evropian. Vitet e fundit ka pasur një rritje të këtyre flukseve migratore, shoqëruar me kontrabandimin e mundshëm të migrantëve që kalojnë tranzit në Shqipëri. Migrantët, të cilët kryesisht vijnë nga Lindja e Mesme, si dhe vendet afrikane dhe aziatike, e kalojnë kufirin shqiptar në mënyrë të paligjshme, shpesh me ndihmën e kontrabanduesve. Rruga më e përdorur është duket kaluar nga pikat e kalimit të kufirit në jug, deri në pikat e kalimit të kufirit në veri të vendit për daljen e tyre nga vendi, ndërsa rruga më pak e përdorur është nëpërmjet detit dhe ajrit.

Nga ana tjetër, qeveria shqiptare ka shtuar përpjekjet e saj për të luftuar kontrabandimin e migrantëve dhe kontrollin kufitar, megjithatë duke marrë në konsideratë kapacitetet aktuale institucionale, situata mbetet sfiduese. Disa shqetësime janë ngritur edhe në lidhje me trajtimin e migrantëve dhe refugjatëve në Shqipëri, duke përfshirë këtu raportime për dhunë, abuzim dhe shfrytëzim, kryesisht nga kontrabanduesit dhe në shumë pak raste ku raportohet përfshirja e zyrtarëve shtetërorë, si p.sh. të Policisë.

Me Programin e ri të Statistikave Zyrtare (2017-2022), të dhënat statistikore në lidhje me migrantët dhe refugjatët janë centralizuar për një bashkëpunim më të mirë ndër-institucional. Për këtë program, të dhënat për të huajt përditësohen nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, ndërsa të dhënat për azilkërkuesit dhe shtetësinë përditësohen nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Nga të dhënat zyrtare të siguruar nga institucionet relevante, rezultojnë se kategoritë e të huajve që vijnë në Shqipëri përfshijnë, ndër të tjera, refugjatë dhe azilkërkues, migrantë, viktimë trafikimi, të mitur të pashoqëruar, si dhe persona pa shtetësi. Disa prej tyre mund t'i përkasin më shumë se një kategorie të vetme. Ata gjithashtu i përkasin kombësive të ndryshme. Shumica janë me origjinë nga Siria dhe Afganistani dhe shpesh qasen në territorin shqiptar në mënyrë të parregullt. Këta individë janë zakonisht në një situatë vulnerabiliteti për shkak të rrethanave sfiduese me të cilat janë përballur në vendet e tyre të origjinës, të tilla si kushtet e vështira të jetesës apo shfrytëzimi e keqtrajtimi që mund të kenë pësuar gjatë udhëtimit të tyre deri në Shqipëri.

Shqipëria, për flukset e migrantëve është kryesisht një vend tranzit në rrugën e tyre drejt Bashkimit Evropian. Megjithatë, për shkak të faktorëve të ndryshëm si stabiliteti politik dhe krizat ekonomike, Shqipëria është kthyer gjithnjë e më shumë në një destinacion apo vend pritës të përkohshëm për të huajt. Për këtë arsye, është thelbësore që këto flukse të menaxhohen dhe kontrollohen siç duhet për të siguruar mbrojtje efektive për migrantët.

5.1. Profili i migrantëve të parregullt të cilët hyjnë dhe dalin nga Shqipëria

Gjatë vitit 2022, në Shqipëri u kapën gjithsej 12.216 migrantë të parregullt, nga të cilët 8.335 ishin shkelës për herë të parë dhe 3.881 ishin recidivistë. Kjo paraqet një rënie prej 6,280 individësh në krahasim me vitin 2021, kur u kapën 18,496 shtetas të huaj të parregullt, nga të cilët 1,062 ishin shkelës për herë të parë dhe 8,434 ishin përsëritës (recidivistë). Rënia e këtyre numrave i atribuohet kryesisht zbatimit të masave më rigorozë parandaluese dhe shtrënguese nga policia e kufirit dhe FRONTEX.

Table 1: Migrantët e parregullt në Shqipëri

2021		2022	
18 496		12 216	
Për herë të parë	Recidivist	Për herë të parë	Recidivist
10 062	8 434	8 335	3 881


Në vitin 2022, Gjirokastra në jug dhe Korça në juglindje, u konsideruan si pika të nxehta, si rrjedhojë e kapjes së numrit më të madh të migrantëve të parregullt në vend, duke përbërë rreth 85% të të gjithë migrantëve të parregullt të kapur.

Table 2: Pikat e nxehta (Hotspots)

2021	2022
89,8%	85%
Korçë & Gjirokastrë	Korçë & Gjirokastrë

Tendenca sa i takon kombësive kryesore të migrantëve të parregullt të kapur në Shqipëri ka mbetur e ngjashme mes viteve 2021 dhe 2022, megjithëse numri i migrantëve të parregullt të cilët i përkasin disa kombësive të caktuara ishte më i lartë në vitin 2021. Në vitin 2021, kombësitë kryesore të migrantëve të parregullt të kapur ishin sirianë (5366), afganë (1377), bangladeshas (832), marokenë (505), pakistanezë (339) dhe irakenë (305). Ndërsa në vitin 2022, numrat u ulën në përgjithësi, dhe kombësitë kryesore ishin sirianë (3030), afganë (1325), bangladeshas (1055), pakistanezë (856), iranianë (311) dhe marokenë (301).

Figure 1: Kombësia e migrantëve të parregullt



5.2. Modus operandi (mënyra e veprimit) i kontrabandimit të migrantëve në Shqipëri

■ Rrugët e përdorura për kontrabandimin

Duke pasur parasysh vendndodhjen strategjike gjeografike të Shqipërisë dhe vendet fqinje të saj si Greqia dhe Maqedonia e Veriut, rrugët kryesore që përdoren zakonisht përfshijnë hyrjen përmes pikave të kalimit të kufirit në jug dhe juglindje të vendit, e ndjekur nga dalja nga territori shqiptar përmes pikave të kalimit të kufirit në veri dhe verilindje, të cilat lidhin Shqipërinë me Malin e Zi dhe Kosovën.

Për shkak se objektivi kryesor për shumicën e migrantëve është të mbërrin në vendet e Bashkimit Evropian, ka pasur pak raste ku Shqipëria ka pritur migrantë të cilët qendrojnë për një kohë të gjatë në vend. Ky fenomen reflektohet drejtpërdrejt dhe në pikat kufitare nga të cilat migrantët zgjedhin të qasen dhe të largohen nga territori shqiptar.

Kështu, pikat kryesore të kalimit të kufirit për të hyrë në Shqipëri janë të përqendruara kryesisht në jug, afër Gjirokastrës, në juglindje pranë Korçës dhe në jugperëndim pranë Sarandës. Në mënyrë të ngjashme, për të dalë nga vendi, migrantët përdorin kryesisht pikat e kalimit të kufirit në veriperëndim të qytetit të Shkodrës, si Muriqani dhe Hani i Hotit, që lidhin Shqipërinë me Malin e Zi. Gjithashtu, rruga më e përdorur në verilindje është përmes pikës së kalimit të kufirit të Morinës që lidh Shqipërinë me Kosovën. Rrugët më pak të përdorura përfshijnë udhëtimin detar dhe ajror. Vlen të theksohet se Aeroporti Ndërkombëtar "Nënë Tereza" në Tiranë ka patur një numër të kufizuar rastesh ku migrantët kanë tentuar të mashtrojnë policinë e kufirit duke përdorur dokumente të falsifikuara si pasaporta, karta identiteti dhe viza. Për shembull, në vitin 2022, u regjistruan 51 raste të migrantëve që tentuan të përdorin dokumente të falsifikuara për të kaluar kufirin. Këto raste përfshinin kryesisht individë që mbërrijnë në Shqipëri nëpërmjet linjave ajrore që lidhen me vendet e Lindjes së Mesme të cilët synonin të shfrytëzonin fluturimet nga Shqipëria për të mbërritur në vendet e BE-së nëpërmjet rrugëve ajrore. Sipas një analize të të dhënave lidhur me ndalimin e migrantëve, rezulton një rritje e lëvizjeve të migrantëve gjatë sezonit turistik.

Gjatë udhëtimit të tyre nëpër Shqipëri, është e zakonshme që migrantët të bëjnë një ndalesë të gjatë ose të shkurtër në kryeqytet, për arsye të ndryshme. Tirana ofron akses në institucionet kryesore ku migrantët mund të kërkojnë mbrojtje ose të aplikojnë për azil. Aplikimet për mbrojtje apo azil kryesisht përdoren nga migrantët për të legjitimuar qëndrimin e tyre të përkohshëm në shtetin shqiptar, ndërkohë që ata përgatiten për të vijuar udhëtimin e tyre. Kësisoj, procedurat për marrjen e statusit të azilantit rrallë herë finalizohen. Gjithashtu, kryeqyteti ofron lloje të ndryshme shërbimesh që mund të mos jenë të disponueshme në qytete të tjera, përfshirë këtu edhe shërbimet e ofruara nga kontrabanduesit.

Në intervistat e realizuara me migrantët e pranishëm gjatë misionëve monitoruese, u vu re një hezitim i tyre për të zbuluar detaje rreth funksionimit apo mbështetjes që kishin nga kontrabanduesit. Megjithatë, të dhënat e marra prej tyre lidhur me metodat e përdorura gjatë këtyre shërbimeve përputheshin.

Kështu, migrantët dhe përfaqësuesit e institucioneve, pranuan një praktikë të zakonshme të përdorur gjatë tentativave të kalimit të kufirit kur migrantët përdornin rrugë nëpër male për të kaluar në mënyrë që të shmangin zbulimin nga policia. Rrugët e përdorura prej tyre janë zakonisht në zona rurale dhe shpesh migrantët kërkojnë strehim në shtëpi të braktisura të cilat kanë kushte tejet të këqija, duke i përdorur ato si strehim të përkohshëm përpara se të vijnë me udhëtimin e tyre.

Shërbimet e kontrabanduesve dhe kostoja

Kontrabanduesit në Shqipëri ofrojnë një sërë shërbimesh për migrantët vulnerabël, ku më e zakonshme është ndihma për kalimin e paligjshëm të kufirit. Shërbimet kryesore të paligjshme që u ofrohen migrantëve me qëllim hyrjen ilegalisht në vend pa qenë shtetas ose pa leje qëndrimi janë strehimi, shoqërimi ose vënia në dispozicion ose përdorimi i mjeteve të transportit.



Për sa i përket transportit, migrantët zgjedhin metoda të ndryshme transporti të ofruara nga kontrabanduesit. Metoda më e zakonshme përfshin përdorimin e furgonëve që lejojnë shumë migrantë të udhëtojnë së bashku ose udhëtimin me taksë. Ka raste kur kontrabandues të caktuar marrin përsipër të gjithë udhëtimin tranzit nëpër vend, ndërsa në raste të tjera, migrantët përdorin kontrabandues të ndryshëm për të bërë transportin në segmente të ndryshme rrugore.

Për shembull, migrantët mund të përdorin një metodë të caktuar transporti nga pikat e kalimit të kufirit jugor drejt Tiranës dhe, më pas, ndërrojnë mjetet e transportit për pjesën tjetër të udhëtimit të tyre drejt pikave të kufirit në veri ku largohen nga vendi. Gjatë përdorimit të këtyre metodave të udhëtimit, siguria e migrantëve është shpeshherë në rrezik. Ka pasur raste kur numri i pasagjerëve në furgona ose makina tejkalon kapacitetin e lejuar, si dhe aksidente me makinë si rezultat i rritjes së shpejtësisë nga drejtuesit për të shmangur kapjen nga policia.

Edhe mjetet e transportit të përdorura kanë evoluar me kalimin e kohës. Së fundmi, ka një tendencë në rritje të marrjes me qera të makinave më të vogla për të udhëtuar përgjatë vendit. Ka raste gjithashtu që kontrabanduesit mund t'i transportojnë vetë migrantët me makinat e marra me qera, duke shmangur kështu konfiskimin e mjetit, por dhe duke kamufluar operimet nëpërmjet ndryshimit të makinave. Nga ana tjetër, për shkak të mungesës së dokumenteve të nevojshme për të marrë me qera një makinë, shpesh kontrabanduesit kërkojnë një pagesë nga migrantët në këmbim të marrjes me qera të një makine në emrin e tyre. Autoritetet ligjzbatuese janë në dijeni të kësaj mënyre transporti në zhvillim dhe i kanë vënë në dijeni bizneset që operojnë në industrinë e makinave me qera, për të rritur ndërgjegjësimin e tyre për këto aktivitete.

Mënyra më e rrezikshme e transportit e përdorur gjatë kontrabandimit të migrantëve vijon të jetë përdorimi i kamionëve dhe mjeteve të tonazhit të rëndë. Migrantët shpesh fshihen në ndarjet e pasme të kamionëve që transportojnë mallra, me ndihmën e shoferëve të kamionëve, në përpjekje për të kaluar ilegalisht kufirin. Megjithatë, ka pasur edhe raste kur vetë migrantët zgjedhin të fshihen në pjesë të rrezikshme të kamionit, edhe në rastet kur shoferi nuk është në dijeni të pranisë së tyre.

Sa i takon pagesave, migrantët e intervistuar dhe përfaqësuesit e institucioneve pranojnë se migrantët duhet të paguajnë para për shërbimet e ofruara nga kontrabanduesit. Gjatë misionëve monitoruese nuk është vërejtur asnjë mënyrë tjetër pagese veç pageses me para në dorë. Vlera e pagesës varet nga shërbimi specifik i kërkuar dhe marrëveshja ndërmjet kontrabanduesit dhe migrantëve ose familjeve të tyre. Për shërbimet brenda Shqipërisë, të cilat përfshijnë kryesisht transportin në të gjithë vendin, pagesat zakonisht variojnë nga 100 deri në 800 Euro për person, në varësi të nivelit të asistencës së kërkuar. Në përgjithësi, migrantët kanë raportuar se kanë paguar nga 5000 deri në 8000 Euro për të gjithë rrugën nga vendi i tyre i origjinës në Shqipëri. Pagesat zakonisht bëhen me para në dorë në momentin kur migrantët marrin shërbimin ose kryhen nga anëtarët e familjes ose të afërmit pasi këta të fundit marrin konfirmimin për vendndodhjen e migrantëve. Agjencitë e transferimit të parave, si *MoneyGram*, gjithashtu përdoren gjerësisht për kryerjen e këtyre pagesave.

5.3. Kontrabanduesit e migrantëve

Kontrabanduesit në Shqipëri ofrojnë një sërë shërbimesh për migrantët vulnerabël, ku më e zakonshme është ndihma për kalimin e paligjshëm të kufirit. Në legjislacionin shqiptar, Kodi Penal përfshin dispozita specifike për ndihmën për kalimin e paligjshëm të kufirit. Neni 298 i Kodit Penal parashikon se *"Strehimi, shoqërimi, vënia në dispozicion ose përdorimi i mjeteve të lundrimit, të fluturimit ose i mjeteve të tjera të transportit apo çdo ndihmë tjetër, me qëllim kalimin e paligjshëm të kufirit të Republikës së Shqipërisë ose për hyrjen e paligjshme të një personi në një shtet tjetër, pa qenë shtetas i tij ose që nuk ka leje qëndrimi në atë shtet, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet."*

Gjatë misionëve të monitorimit, migrantët kanë pranuar se kanë përfituar nga shërbimet e ofruara nga kontrabanduesit gjatë gjithë rrugëtimit të tyre, përfshirë edhe në Shqipëri. Dëshmitë e tyre tregojnë se ekziston një bashkëpunim i kontrabanduesve përtej kufijve, duke marrë në konsideratë se kontrabanduesit që i kanë ndihmuar ata kanë qënë të kombësive të ndryshme dhe ka pasur raste kur kontrabanduesit në vende të tjera, si p.sh. Greqi apo Turqi, i kanë vënë në kontakt me njerëz që mund t'i ndihmonin me shërbime të ndryshme në Shqipëri apo vende të tjera.

Nga misionet e monitorimit gjithashtu ka rezultuar se, kontrabanduesit mbajnë lidhje edhe me familjet e migrantëve që banojnë në vendet e BE-së. Përzgjedhja e kontrabanduesve shpesh herë bazohet në përvojat e mëparshme ose lidhjet e familjarëve, miqve apo të afërmeve të tyre, të cilët kanë migruar në vendet e BE-së dhe kanë përdorur më parë shërbimet e këtyre kontrabanduesve. Në disa raste, familjarët e migrantëve marrin përsipër organizimin e shërbimeve të ndryshme të nevojshme për migrantët gjatë udhëtimit të tyre dhe madje paguajnë edhe kontrabanduesit për shërbimet e tyre.

Kontrabanduesit koordinojnë me përpikmëri çdo aspekt të lëvizjeve të migrantëve, duke u dhënë atyre udhëzime konkrete për veprimet që duhet të ndërmerren. Nëse ndodh që një kontrabandues të kapet, planet e lëvizjeve ndërrohen dhe përshtaten në përgjigje të situatës. Kontrabanduesit zakonisht nuk e kalojnë kufirin me migrantët, por përdorin udhëzime lokale për të vijuar udhëtimin e tyre. Ata shpesh i orientojnë migrantët duke u mësuar atyre shtigje kalimi për të evituar rrezikun e kapjes së tyre gjatë kalimit të kufirit.

Migrantët, të cilët u intervistuan gjatë misioneve monitoruese, pohuan se kontaktet e kontrabanduesve i gjejnë edhe përmes rrjeteve sociale. Teknologjia e ka thjeshtuar kontrabandimin pasi kontrabanduesit i reklamojnë shërbimet e tyre në rrjetet sociale, ndërsa migrantët mbajnë kontakte me kontrabanduesit përmes *Whatsapp* ose *Viber*, por edhe duke blerë aplikacione të posaçme në internet të cilat instalohen për të aksesuar rrugët që duhet të ndiqen nga migrantët përmes videove dhe fotove të shpërndara nga kontrabanduesit.

Profili i kontrabanduesve

Tradicionalisht, kontrabanduesit kryesorë që ofronin shërbimet e kërkuara nga migrantët janë shtetas të vendit të destinacionit, pra, në këtë rast, Shqipërisë. Megjithatë, me kalimin e kohës vërehet një ndryshim në shtimin e rasteve kur vetë migrantët janë përfshirë në kontrabandim, duke bashkëpunuar me kontrabanduesit në Shqipëri, dhe duke ofruar shërbime të ndryshme për bashkëudhëtarët e tyre që kërkojnë të kalojnë kufirin. Si rezultat, profili i kontrabanduesve është zgjeruar duke përfshirë individë nga Iraku, Afganistani, Siria, Algjeria dhe kombësi të tjera. Mosha mesatare e vëzhguar e këtyre kontrabanduesve është zakonisht mes 30 dhe 35 vjeç.

Kodi Penal në Shqipëri përfshin parashikime specifike kur kontrabanduesit veprojnë në bashkëpunim me të tjerë. Në këtë rast dënimi për këtë veprë penale është nga 5 deri në 10 vite burgim. Zakonisht kontrabanduesit veprojnë si pjesë e një grupi më të madh jo të sofistikuar, duke ruajtur lidhjet brenda rrjetit gjatë gjithë udhëtimit nga vendi i origjinës dhe duke vazhduar në vende të ndryshme përgjatë lëvizjeve të migrantëve. Brenda grupit të migrantëve, ka raste kur individë të caktuar marrin rolin e kontrabanduesve dhe janë përgjegjës për lehtësimin e komunikimit dhe udhëheqjen e grupit gjatë udhëtimit nga një vend në tjetrin.

Nga dëshmitë e migrantëve dhe përfaqësuesve të institucioneve, vërehet se në Shqipëri kontrabandimi operohet më shumë në baza individuale sesa si një grup i organizuar. Roli kryesor i kontrabanduesve shqiptarë mbetet koordinues dhe transportues.

Qytetarët mund të marrin gjithashtu rolin e udhërrëfyesve lokalë kur migrantët kalojnë nëpër qytetin e tyre. Si udhërrëfyes, roli i tyre është i kufizuar në ofrimin e këshillave për migrantët kryesisht se si të gjejnë shoferët e taksive që mund t'i transportojnë sipas itinerarit të tyre të planifikuar. Këta taksistë nuk zgjidhen rastësisht, por janë të përfshirë specifikisht në lehtësimin e kalimit të paligjshëm të kufirit të migrantëve duke i shoqëruar apo transportuar ato. Gjithashtu, ka raste kur migrantët përdorin hotele, motele ose shtëpi me qera, megjithatë mënyra më e zakonshme e akomodimit është strehimi në shtëpi të braktisura për të minimizuar ngritjen e dyshimeve tek autoritetet shtetërore.

Bazuar në intervistat e kryera me përfaqësues të Prokurorisë së Rrethit Kukës, që ndodhet në afërsi të kufirit me Kosovën, vetëm për këtë qark gjatë vitit 2022 ka pasur 19 raste që kanë rezultuar në ndjekje penale për ndihmën e ofruar për kalimin e paligjshëm të kufirit. Të gjithë personat e përfshirë në këto raste ishin shtetas shqiptarë. Veprat penale ishin në përputhje me nenin 298 të Kodit Penal. Nga 19 raste të proceduara në vitin 2022, 3 prej tyre janë transferuar për moskompetencë, 2 raste janë mbyllur për mungesë provash, 10 çështje janë dërguar në gjykatë dhe 4 raste janë ende në hetim.

Krahas kontrabanduesve, shqetësuese është edhe përfshirja e personelit të policisë për ofrimin e ndihmës për kalimin e paligjshëm të kufirit për migrantët. Nga intervistat me përfaqësues të autoriteteve rezultoi se disa anëtarë të policisë u ofrojnë ndihmë migrantëve duke shkëmbyer informacione lidhur me patrullat e policisë

në segmente të veçanta rrugore ose edhe duke i shoqëruar migrantët duke përdorur automjetet e policisë për të lehtësuar kalimin e kufirit.¹⁰

Për anëtarët e autoriteteve shtetërore, në këtë rast të Policisë, neni 298 i Kodit Penal *“Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”* parashikon se *“Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të një funksioni shtetëror ose shërbimi publik, dënohet me burgim shtohet me një të katërtën e dënimit të dhënë”*. Për më tepër, si nëpunës civilë, ndërsa përfshihen në aktivitete të paligjshme për të ndihmuar migrantët e parregullt, oficerët e policisë mund të jenë subjekt i shumë veprave të tjera penale, si *‘Shpërdorimi i detyrës’*; *“Vjedhja nëpërmjet shpërdorimit të detyrës”*¹¹, *“Korrupsioni pasiv nga personat që ushtrojnë funksione publike”*¹² etj. Përfshirja e punonjësve të policisë në kontrabandimin e migrantëve ngre shqetësime të rëndësishme për integritetin dhe efektivitetin e zbatimit të ligjit në trajtimin e migracionit të paligjshëm.

5.3. Migrantët e kontrabanduar

Gjatë vitit 2022, në Shqipëri u kapën gjithsej 12,216 migrantë të parregullt. Shumica prej tyre janë shpesh në situatë vulnerabël, si rezultat i rrethanave të vështira në vendet e tyre të origjinës ose për shkak të shfrytëzimit ose keqtrajtimit me të cilin janë përballur gjatë udhëtimit të tyre. Për këtë arsye, ata janë në një pozitë të pafavorshme përballë kontrabanduesve, të cilët mund të përfitojnë nga vulnerabiliteti i tyre për përfitime personale.

Ndihma prej kontrabanduesve nuk ofrohet falas. Migrantët janë të detyruar t’u paguajnë atyre shumën e rënë dakord për shërbimet e tyre. Megjithatë, ka raste kur migrantët mund ta gjejnë veten në pamundësi për të përmbushur detyrimet e tyre financiare ndaj kontrabanduesit. Në raste të tilla, si përfaqësues nga institucionet e monitoruara, ashtu edhe migrantë të intervistuar kanë pohuar se kur migrantët nuk janë në gjendje të paguajnë, kontrabanduesit i grabisin ato dhe u marrin sendet personale. Në rastet kur migrantët e kontrabanduar janë të organizuar në grupe të drejtuara nga një migrant i cili është edhe në rolin e kontrabanduesit, dhe kur një migrant nuk është në gjendje të paguajë shërbimin, ai zakonisht lihet pas dhe nuk lejohet të ndjekë grupin.

Nga monitorimi u vërejt se lidhur me dhunën e përdorur, kontrabanduesit më shpesh përdorin dhunë psikologjike ose verbale sesa dhunë fizike. Kjo mund t’i atribuohet edhe faktit se kontrabanduesit mund të druhen se migrantët mund ta raportojnë dhunën fizike tek autoritetet përkatëse. Për këtë arsye, mjeti kryesor që përdorin kontrabanduesit është duke i kërcënuar dhe detyruar migrantët të mos flasin për gjërat që u ndodhin atyre.

Këto tendenca konfirmohen edhe nga autoritetet shtetërore. Sipas përfaqësuesit të Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit në Korçë, janë raportuar të paktën dy raste kur migrantët kanë pretenduar se janë kërcënuar dhe se u janë konfiskuar paratë dhe telefonat nga kontrabanduesit. Megjithatë, u konstatua se nuk ka të dhëna për procedura ligjore të ndërmarra ndaj këtyre kontrabanduesve.

I Të miturit e pashoqëruar

Të miturit e pashoqëruar janë kategoria më vulnerabël në mesin e migrantëve të kontrabanduar. Të dhënat për periudhën 2019-2022 tregojnë se më shumë se 2000 të mitur të pashoqëruar kanë hyrë në Shqipëri. Megjithatë, aktualisht asnjë prej tyre nuk ka mbetur në vend dhe autoritetet shqiptare nuk kanë mundur t’i kthejnë në mënyrë të sigurtë në vendin e origjinës, sepse zakonisht ata arratisen dhe vijnë udhëtimin e tyre. Të gjithë të miturit e identifikuar të pashoqëruar kanë qenë meshkuj. Vendet e origjinës së tyre kryesisht përfshijnë Afganistanin, Somalinë, Sirinë, Irakun, Palestinën, Egjiptin.

Monitorimi i tendencave lidhur me të miturit e pashoqëruar u fokusua në dy nga pikat më të mëdha të kalimit kufitar në jug të Shqipërisë: Kapshticë dhe Kakavijë, të cilat janë gjithashtu pikat me fluksin më të madh të hyrjeve të paligjshme të migrantëve.

10 [Procedohen dy policë të kufirit në Sarandë, i morën ryshfet një emigranti – Euronews Albania.](#)

11 Në rastet kur marrin sendet personale të migrantëve.

12 Në rastet kur kërkohet apo marrin pagesë për ndihmën e tyre.

Pika e kalimit të kufirit	Viti	Numri i të miturve të pashoqëruar
Kakavije	2019	Nuk ka informacion
Kakavije	2020	Nuk ka raste të regjistruara
Kakavije	2021	13 të mitur të pashoqëruar
Kakavije	2022	19 të mitur të pashoqëruar
Kapshtice	2019	Nuk ka raste të regjistruara
Kapshtice	2020	19 të mitur të pashoqëruar
Kapshtice	2021	8 të mitur të pashoqëruar
Kapshtice	2022	13 të mitur të pashoqëruar

Intervistat e kryera me autoritetet shtetërore përgjegjëse për trajtimin e rasteve që përfshijnë të mitur të pashoqëruar konfirmojnë një trend të ngjashëm me migrantët e rritur sa i takon rrugëve të përdorura dhe shërbimeve të ofruara nga kontrabanduesit për këta të mitur. Megjithatë, autoritetet nuk kanë informacion të verifikuar sa i takon funksionimit të kontrabandimit apo menyrës se si të miturit e pashoqëruar gjejnë kontaktet e kontrabanduesve për shërbimet e tyre. Edhe të miturit e pashoqëruar e konsiderojnë Shqipërinë kryesisht si një vend tranzit për të arritur në vendet e BE-së, veçanërisht për t'u bashkuar me familjet e tyre që banojnë atje.

Sipas Policisë, një numër i konsiderueshëm i migrantëve që kategorizohen si të mitur dyshohet se janë mbi 18 vjeç. Megjithatë, për shkak të mungesës së të dhënave alternative dhe metodave të besueshme të identifikimit të tyre, autoritetet janë të detyruara të mbështeten në deklaratat e dhëna nga këta individë. Dyshohet shpesh se migrantët pretendojnë se janë nën 18 vjeç për të përfutur trajtimin dhe mbrojtjen e veçantë që u jepet të miturve.

5.5. Bashkëpunimi me autoritetet kompetente

Edhe pse migrantët mund të përjetojnë dhunë, grabitje, kërcënime ose përdorim të forcës, vërehet se ata nuk nisin procedura ligjore kundër kontrabanduesve apo autorëve të këtyre veprimeve. Kjo mund t'i atribuohet faktorëve të ndryshëm, si frika, mungesa e ndërgjegjësimit se si të raportohen incidentet të tilla, ose ngurrimi për t'i raportuar ato për shkak të synimit të migrantëve për të përdorur shërbimet e këtyre kontrabanduesve për të shkuar në vendet e Bashkimit Evropian nëpërmjet Shqipërisë. Bazuar në të dhënat në terren, rezultoi se migrantët zakonisht nuk përfshihen në procedime penale. Kjo vjen kryesisht për shkak të zgjatjes së procedurave të tilla, veçanërisht nëse ato përfshijnë paraqitjen në gjykatë. Në kohën kur migrantët thirren nga gjykata, ka shumë gjasa që ata të jenë larguar nga Shqipëria.

Kontrabanduesit dhe shërbimet e tyre zakonisht zbulohen në flagrancë. Nga të dhënat në terren është raportuar vetëm një rast ku një migrant i parregullt ka bërë denoncim ndaj dy policëve që i kishin vjedhur paratë dhe celularin¹³. Për pasojë, të dy efektivet e policisë u akuzuan për veprat penale 'Vjedhje e kryer duke shpërdoruar detyrën'¹⁴ dhe 'Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike'¹⁵.

Në rrjedhojë të sa më sipër, nuk u evidentuan raste kur organizatat kanë ndihmuar migrantët për fillimin e procedurave ligjore kundër kontrabanduesve. Nga ana tjetër, OJQ-të kryesisht ofrojnë ndihmë juridike falas për procedurat e azilit, mbështetje gjatë procesit të kthimit, ndihmë në apelimin e vendimeve lidhur me kërkesat e tyre, ofrimin e ndihmës humanitare dhe mbështetje psikologjike. OJQ-të luajnë një rol vendimtar në mbështetjen e rasteve që përfshijnë të mitur (përfshirë të mitur të pashoqëruar) dhe gra që mund të jenë të pambrojtura ndaj trafikimit dhe shfrytëzimit. OJQ-të përfshihen kryesisht pas kapjes së migrantëve, ndërsa për sa i përket parandalimit të kontrabandës, roli kryesor i tyre është fokusuar më së shumti në ndërgjegjësimin për rreziqet dhe gjithashtu përgjegjësinë ligjore të kontrabanduesve për aktivitete të paligjshme.

13 [Arrestohet një punonjës policie në Qafë Botë, një tjetër procedohet: I vodhi paratë dhe telefonin një pakistanezi – Saranda Neës.](#)

14 Në rastet kur marrin sende personale të migrantëve.

15 Në rastet kur kërkojnë pagesë për ndihmën ndaj migrantëve.

5.6. Parandalimi i kontrabandimit dhe mbrotja e migrantëve të kontrabanduar

Shqipëria ka zbatuar një sërë masash për adresimin e kontrabandimit të migrantëve. Këtu përfshihen masa parandaluese dhe masa mbrojtëse që synojnë luftimin e problematikës. Kjo është parashikuar si një prej masave konkrete për të arritur plotësimin e objektivit specifik B në Strategjinë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit 2019–2022¹⁶. Aktualisht, institucionet shqiptare po punojnë për miratimin e Strategjisë së re Kombëtare për Migracionin. Strategjia ka parashikuar si një objektiv specifik (B) që autoritetet përkatëse të garantojnë migracion të sigurt dhe të rregullt nga, përmes dhe drejt Shqipërisë. Masat e parashikuara do të kontribuojnë në zbulimin e migrantëve të parregullt në kufi dhe në territorin e Shqipërisë si dhe identifikimin më të mirë të kategorive vulnerabël ndaj kontrabandimit, përmes procedurave të *pre-screening* dhe të referuara në shërbimet e mbrojtjes.

Si masë parandaluese, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit për 2019-2022, u miratua Plani i Kontigjencës, për të ofruar mbështetje gjatë flukseve masive migratore të përziera, duke i kushtuar vëmendje të veçantë individëve vulnerabël si p.sh: të mitur të pashoqëruar, viktimat të trafikimit, azilkërkues dhe persona me aftësi të kufizuara. Plani i kontigjencës synon të garantojë të drejtat e azilkërkuesve dhe migrantëve dhe sigurinë e tyre, nëpërmjet analizës dhe përpunimit të të dhënave, ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës gjatë zhvendosjes, evakuimit, akomodimit në situata emergjente, ushqimit, kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve psiko-sociale.

Ndërkohë, njëkohësisht si masë parandaluese dhe mbrojtëse theksohet nevoja për kapacitete institucionale. Autoritetet shqiptare janë angazhuar për përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës në kufirin e vendit dhe brenda territorit, me qëllim forcimin e kontrollit të migracionit duke mbrojtur të drejtat e migrantëve. Modernizimi i pajisjeve dhe infrastrukturës së menaxhimit të kufirit për të forcuar mbikëqyrjen kufitare është një mënyrë tjetër që kontribuon në shtimin e rasteve të identifikuara të kontrabandimit. Gjithashtu, me ndihmën e partnerëve si Avokati i Popullit, UNHCR, IOM, autoritetet shqiptare kanë prodhuar fletëpalosje/broshura mbi procesin e *pre-screening* dhe të drejtat e migrantëve të cilat janë shpërndarë në pikat e kalimit të kufirit për të garantuar të drejtën për të marrë informacion mbi fazat e procesit të shqyrtimit paraprak (*pre-screening*) për migrantët.

Shqipëria ka miratuar gjithashtu Strategjinë Kombëtare kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe Planin e Veprimit 2021–2022 (2020) për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore. Kjo strategji dhe plani shoqëruar i veprimit synojnë *“të garantojnë që qeveria shqiptare dhe të gjithë aktorët shtetërorë dhe joshetërorë të jenë të përkushtuar për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe sigurimin e mbrojtjes nga trafikimi të individëve dhe grupeve në nevojë. Aktivitetet kryesore përfshijnë rritjen e ndërgjegjësimit të personave relevantë, institucioneve si dhe kompanive private për të identifikuar rreziqet e trafikimit, miratimin ose ndryshimin e ligjeve dhe rregulloreve dhe trajnimin e profesionistëve që punojnë me viktimat e trafikimit, përfshirë gratë, burrat dhe fëmijët. Strategjia përmend në mënyrë të veçantë migrantët brenda objektivit të saj për të siguruar “trajnimin e oficerëve të policisë së kufirit dhe migracionit, zyrtarët e azilit dhe personelit të qendrave të pritjes dhe strehimit për të rritur kapacitetet për identifikimin e viktimave të trafikimit mes azilkërkuesve, migrantëve dhe fëmijëve të pashoqëruar”.*

Proceset dhe mjetet: Procedurat e hyrjes dhe qëndrimit në vend shërbejnë si instrumente efektive për parandalimin dhe reduktimin e migrimit të parregullt dhe kontrabandimit të mundshëm të migrantëve vulnerabël. Për këtë arsye, autoritetet shqiptare monitorojnë rregullisht efektivitetin e procedurave standarde në fuqi për verifikimin e qëllimit të hyrjes dhe qëndrimit gjatë të gjitha fazave dhe minimizojnë rastet e qëndrimit dhe tranzitit të parregullt duke kontrolluar ligjshmërinë e qëndrimit dhe duke marrë masa kur vërtetohet shkelja e ligjshmërisë së qëndrimit si dhe duke u dhënë migrantëve informacione për sa më sipër.

Masa të tjera parandaluese nga institucionet përgjegjëse për menaxhimin e migracionit përfshijnë:

- Rritja e ndërgjegjësimit të migrantëve për pasojat e kalimit të paligjshëm të kufirit dhe rreziqet që lidhen me kontrabandimin;

16 https://mb.gov.al/ep-content/uploads/2021/02/Strategjia-Kombëtare-për-Migracionin-dhe-Plani-i-Veprimit_2019-2022.pdf

- Forcimi i partneritetit me organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare për të ndihmuar migrantët vulnerabël duke ofruar një sërë shërbimesh, përfshirë shpërndarjen e informacionit dhe mbështetjen gjatë procedurave ligjore;
- Zhvillimi dhe përmirësimi i mekanizmave dhe procedurave për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive kërcënimeve që vijnë prej kontrabandimit dhe trafikimit të qenieve njerëzore, me fokus të veçantë në grupet vulnerabël;
- Promovimi i ndërgjegjësimit të publikut, veçanërisht brenda komuniteteve që banojnë pranë pikave të kalimit të kufirit ku kontrabandimi është shqetësim më i madh, për rreziqet që lidhen me kontrabandimin dhe trafikimin e qenieve njerëzore, si dhe inkurajimi i individëve që të ndërmarrin veprime për të raportuar aktivitete të tilla nëse i ndeshin ato;
- Rritja e bashkëpunimit dhe shkëmbimi i njohurive me vendet fqinje mbi rreziqet dhe metodat e kontrabandimit dhe trafikimit të qenieve njerëzore, duke rezultuar në zbulimin dhe kapjen e më shumë rasteve.

6. Shtojca 1: Propozim për bashkëpunim midis OshC-ve dhe autoriteteve përgjegjëse – Procedura Kombëtare Standarde të Operimit (NSOPs)

Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve kompetente dhe organizatave të shoqërisë civile (OShC) është i një rëndësie të veçantë për të rritur efektivitetin, transparencën dhe llogaridhënien në përpjekjet e përbashkëta që synojnë trajtimin e çështjeve të kontrabandimit të migrantëve dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Duke marrë parasysh rolin e Organizatave të Shoqërisë Civile (OShC) në Shqipëri në mbështetjen e ofruar si për institucionet kompetente ashtu dhe për migrantët, si dhe kuadrin ligjor ekzistues që parashikon përfshirjen e tyre, ky propozim synon të zyrtarizojë bashkëpunimin midis OShC-ve dhe autoriteteve shtetërore. Objektivi kryesor është krijimi i Praktikave Standarde Kombëtare të Operimit (NSOP). Këto praktika janë krijuar për të promovuar dhe siguruar bashkëpunim efikas dhe përgjigje të koordinuara në adresimin e sfidave që lidhen me mbrojtjen dhe ndihmën e migrantëve të kontrabanduar.

Praktika standarde e operimit fillimisht zyrtarizohet nëpërmjet një Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për migracionin¹⁷ dhe OShC-ve ose rrjetit të OShC-ve të përfshira në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë në mbrojtjen e të drejtave të migrantëve. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi shërben si dokument themelor për përcaktimin e parashikimeve, përgjegjësisë dhe kornizës së bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe OShC-ve.

Fushat prioritare

Bashkëpunimi ndërmjet palëve përfshin, por nuk kufizohet në:



Shkëmbimi i informacionit dhe të dhënave



Rritja e kapaciteteve dhe trajnimi



Shërbime mbështetëse për migrantët



Koordinimi i përpjekjeve



Rritja e ndërgjegjësimit



Monitorimi dhe vlerësimi

Shkëmbimi i informacionit dhe të dhënave

Objektivi i shkëmbimit të informacionit dhe i shkëmbimit të të dhënave është adresimi i menjëhershëm i çështjeve të identifikuara që lidhen me migrantin, si dhe grumbullimi i informacionit në një vend të centralizuar për planifikimin në të ardhmen.

Mjetet e shkëmbimit të informacionit dhe shkëmbimit të të dhënave përfshijnë të dhëna statistikore, takime të rregullta, raporte, minuta intervistash me migrantët, platforma shkëmbimi informacioni etj.

Palët në Marrëveshje angazhohen të ndajnë informacione dhe të dhëna për migrantët, kontrabandimin dhe trafikimin e qenieve njerëzore në baza tremujore. Shkëmbimi i të dhënave duhet të respektojë parashikimet ligjore dhe etike sa i takon privatësisë dhe konfidencialitetit të të dhënave.

Në rast të flukseve migratore, frekuenca e shkëmbimit të informacionit rregullohet të jetë në baza mujore.

Për rastet e identifikuara për mbështetje, informacioni ndahet menjëherë nga autoritetet qeveritare dhe OShC-të duke përshkruar kërkesën për mbështetje nga të dyja palët.

¹⁷ Ministria a Brendshme dhe institucionet e tjera relevante.

■ Rritja e kapaciteteve dhe trajnimi

Objektivi i rritjes së kapaciteteve dhe trajnimit është rritja e aftësive, njohurive dhe burimeve të autoriteteve shtetërore përgjegjëse për migracionin për të kryer detyrat e tyre në mënyrë më efektive dhe efikase, për të marrë vendime të informuara dhe për t'iu përshtatur nevojave në zhvillim brenda juridiksioneve të tyre.

Mjetet e ngritjes së kapaciteteve dhe trajnimeve përfshijnë: *workshop* dhe seminarët, trajnimet dhe mentorim në vendin e punës, vizitat studimore dhe vizitat në terren, programe shkëmbimi me homologët vendorë, rajonalë dhe ndërkombëtarë, konferencat dhe konventat.

Autoritetet shtetërore përgjegjëse për migracionin do të vlerësojnë, identifikojnë dhe paraqesin nevojat për trajnimin e personelit që merret me migracionin tek OShC-të në baza vjetore. Kjo synon të rrisë aftësitë teknike dhe profesionale të këtyre individëve, duke garantuar mbrojtjen dhe respektimin e plotë të lirive dhe të drejtave të individëve, veçanërisht grupeve vulnerabël, të cilët kalojnë kufirin.

OSHC-të duhet të integrojnë nevojat për ngritjen e kapaciteteve të personelit në programet e tyre dhe të adresojnë kërkesën për ngritjen e kapaciteteve përmes mbledhjes së fondeve.

Palët e përfshira do të punojnë së bashku për të krijuar programe trajnimi dhe kurrikula që do të përfshihen në trajnimin standard për punonjësit e rinj dhe ekzistues të stafit që janë të angazhuar me migrantët.

■ Shërbime mbështetëse për migrantët

Objektivi i shërbimeve mbështetëse për migrantët është të garantojë ndihmë, mbrojtje dhe burime gjithëpërfshirëse për migrantët në mënyrë që të adresojë nevojat dhe sfidat e tyre unike.

Mjetet e ofrimit të shërbimeve mbështetëse për migrantët përfshijnë mbrojtjen, nevojat bazë, ndihmën ligjore, mbështetjen psikosociale, kujdesin shëndetësor, strehimin, përkthimin etj.

Palët në Marrëveshje zotohen të rrisin bashkëpunimin në rastet kur nevojiten shërbime mbështetëse.

Autoritetet shtetërore identifikojnë rastet e migrantëve, grupeve vulnerabël, viktimave të kontrabandimit dhe trafikimit dhe vlerësojnë nevojën për shërbimet e nevojshme. Pas identifikimit, autoritetet shtetërore kontaktojnë listën e OShC-ve që ofrojnë ndihmë të ngjashme me mbështetjen e nevojshme duke ofruar kontributin specifik nga OShC-të për të garantuar respektimin e të drejtave të migrantëve. Ky bashkëpunim synon të krijojë një përgjigje të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse ndaj nevojave të migrantëve në vështirësi.

Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) pritjet që të ofrojnë menjëherë mbështetjen e nevojshme sa më shpejt të jetë e mundur, si dhe duhet të raportojnë me shkrim në lidhje me rolin dhe kontributin e tyre specifik në ofrimin e një shërbimi specifik për autoritetet shtetërore.

Autoritetet shtetërore do të sigurojnë të gjitha lejet e nevojshme për anëtarët e OShC-ve për të hyrë menjëherë në të gjitha objektet e mbyllura dhe të hapura ku mbahen migrantët për të ofruar mbështetje.

■ Koordinimi i përpjekjeve

Objektivi i koordinimit të përpjekjeve ndërmjet Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) dhe autoriteteve shtetërore për t'iu përgjigjur çështjeve që lidhen me kontrabandimin dhe trafikimin e migrantëve është krijimi i një qasjeje bashkëpunuese, gjithëpërfshirëse dhe efektive për të luftuar këto aktivitete dhe për të mbështetur viktimat.

Mjetet e koordinimit të përpjekjeve përfshijnë: aktivitete dhe evente të përbashkëta në lidhje me sfidat dhe zgjidhjet e çështjeve të kontrabandimit dhe trafikimit të migrantëve, task forcat e përbashkëta për monitorimin e situatës në kufi, etj.

Autoritetet shtetërore do të përfshijnë OShC-të në diskutimet dhe tryeza të rrumbullakëta për të adresuar çështjet kyçe lidhur me migracionin dhe takimet konsultative mbi miratimin e politikave, strategjive dhe legjislacionit në lidhje me migracionin, kontrabandimin dhe trafikimin.

OShC-të do të konsultohen me autoritetet shtetërore për gjetjet gjatë punës së tyre me migrantët, grupet vulnerabel dhe viktimat e kontrabandimit dhe trafikimit përpara se informacioni të bëhet publik, për t'u siguruar që palët e interesuara të jenë të informuara.

Të dyja palët caktojnë një pikë kontakti, përgjegjëse për lehtësimin e koordinimit të përpjekjeve nga të dyja palët. Këto pika koordinimi shërbejnë si ndërlidhës kryesorë për të siguruar komunikim efektiv, bashkëpunim dhe shkëmbim të informacionit dhe burimeve.

■ Rritja e ndërgjegjësimit

Objektivi i ndërgjegjësimit është të rrisë vetëdijësimin dhe të kuptuarit e publikut për riskun, rreziqet dhe pasojat që lidhen me kontrabandimin e migrantëve. Kjo përfshin informimin e individëve për metodat dhe praktikatat të përdorura nga kontrabanduesit. Rritja e ndërgjegjësimit është thelbësore për t'u ofruar migrantëve informacion në lidhje me të drejtat e tyre, opsionet e migracionit të ligjshëm dhe rreziqet e përfshirjes me kontrabanduesit. Kjo i fuqizon ata të bëjnë zgjedhje të informuara dhe të mos bëhen viktimat.

Mjetet e ndërgjegjësimit përfshijnë: Fushata ndërgjegjësuere, materiale të botuara (fletëpalosje, broshura, postera, fletushka), evente, media etj.

Autoritetet shtetërore identifikojnë nevojën për materiale ndërgjegjësuere, përmbajtjen dhe audiencën e synuar.

OShC-të ofrojnë materiale promovuese *ad hoc* bazuar në kërkesat e autoriteteve shtetërore duke adresuar njëkohësisht nevojat e audiencës së synuar për sa i përket gjuhës së përdorur dhe informacionit në lidhje me të drejtat dhe procedurat për të migruar ligjerisht në vend.

■ Monitorimi dhe vlerësimi

Objektivi i monitorimit dhe vlerësimit është të vlerësojë progresin, efektivitetin dhe ndikimin e veprimeve të ndërmarra nga autoritetet shtetërore në zbatimin e kuadrit rregullator në lidhje me migracionin dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve.

Mjetet e monitorimit dhe vlerësimit: misionet tematike dhe *ad hoc* monitoruese, intervistat, grumbullimi i të dhënave, anketat dhe pyetësorët etj.

Autoritetet shtetërore sigurojnë lejet e nevojshme të anëtarëve të OShC-ve për të hyrë lehtësisht në ambientet ku mbahen migrantët me qëllim vlerësimin e zbatimit të kërkesave ligjore dhe respektimin e të drejtave të tyre.

OShC-të do të dorëzojnë raportin e monitorimit tek institucionet e monitoruara për konsultim përpara publikimit të gjetjeve.

OShC-të do t'u paraqesin autoriteteve shtetërore ankesat e migrantëve në lidhje me trajtimin në objektet ku akomodohet (stacionet e policisë, qendrat e mbyllura dhe të hapura, pikat e kalimit të kufirit) si dhe pretendimet për keqtrajtim ose shkelje të tjera të lirive dhe të drejtave të tyre, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e praktikave.

Kanalet për të lehtësuar bashkëpunimin

Krijimi i një bashkëpunimi efektiv ndërmjet Organizatave të Shoqërisë Civile (OShC) dhe autoriteteve shtetërore përfshin përdorimin e kanaleve të ndryshme të komunikimit dhe koordinimit, duke përfshirë:

- Tryeza të rrumbullakëta për të adresuar çështjet kryesore
- Konsultime për miratimin e politikave, strategjive dhe legjislacionit në lidhje me migrantët, kontrabandimin dhe trafikimin e qenieve njerëzore
- Komitetet e përbashkëta ose grupet e punës
- Takimi vjetor i Autoriteteve shtetërore – OShC-ve
- Koordinatorë të dedikuar ndërlidhës

Kohëzgjatja e marrëveshjes

Marrëveshja e Bashkëpunimit do të lidhet për një periudhë dy-vjeçare me të drejtë rinovimi me marrëveshje të palëve. Ky afat kohor i kufizuar lejon vlerësimin e efektivitetit të bashkëpunimit dhe parandalon një ofrim të pacaktuar të shërbimeve. Gjithashtu ofron një mundësi për të rishikuar dhe përshtatur marrëveshjen sipas nevojave.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve apo detyrimeve ndërmjet palëve, siç parashikohet në këtë marrëveshje bashkëpunimi, arrihet me negociata dhe mirëkuptim të ndërsjellë.

Marrëveshja e Bashkëpunimit mund të ndërpritet brenda 30 ditëve nëse njëra palë njofton me shkrim palën tjetër, duke shprehur vendimin për ndërprerjen e bashkëpunimit.

7. Konkluzione dhe rekomandime

1. Pavarësisht se kapacitetet institucionale janë rritur, nevojiten përmirësime të mëtejshme në aspektin e kapaciteteve logjistike dhe strukturore të institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e migracionit.
2. Është thelbësore që institucionet kyçe, si Departamenti i Kufirit dhe Migracionit, të përmirësojnë dhe modernizojnë pajisjet e përdorura për mbikëqyrjen e kufirit. KShH sugjeron t'i jepet përparësi planifikimit dhe shpërndarjes së fondeve për pajisje të tilla, ndërsa paralelisht të punohet për të garantuar edhe bashkëpunimin me donatorët për të siguruar blerjen e tyre. Kjo qasje proaktive synon përmirësimin e aftësive të menaxhimit të kufirit dhe do të mundësojë një përgjigje efektive ndaj rasteve të kontrabandimit të migrantëve dhe kalimeve të paligjshme të kufirit.
3. Aktualisht, ka mungesë të personelit përgjegjës për kontrollin e kufirit dhe profesionistëve të vijës së parë (përkthyes, mjekë, avokatë), duke penguar trajtimin në mënyrë efektive të fluksit të migrantëve. KShH sugjeron që organet shtetërore të marrin masa për të rritur numrin e personelit, qoftë dhe duke i angazhuar ata me kontratë dhe duke përmirësuar aftësitë e tyre nëpërmjet programeve të trajnimit. Me rritjen e aftësive dhe njohurive të tyre, këta individë do të jenë të gatshëm për t'u angazhuar në përmbushjen e nevojave të menjëhershme dhe adresimin e shqetësimeve të migrantëve të kapur, veçanërisht në identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit dhe ofrimin e ndihmës për grupet më vulnerabël si gratë, të miturit dhe të miturit e pashoqëruar.
4. Shqipëria ka përfunduar zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit 2019-2022 dhe aktualisht po punon për objektivat e ardhshme në fushën e migracionit në hartimin dhe zbatimin e një dokumenti të ri kombëtar dhe gjithëpërfshirës strategjik. KShH rekomandon pjesëmarrjen aktive të aktorëve të ndryshëm, veçanërisht organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë shërbime të ndryshme për migrantët, në procesin e konsultimit. Është gjithashtu thelbësore që të përfshihen njohuritë e marra nga Strategjia e mëparshme Kombëtare për të adresuar çdo mangësi dhe për të përmirësuar dokumentin e ardhshëm.
5. Për të forcuar përpjekjet në parandalimin dhe identifikimin e kontrabandimit të migrantëve, është thelbësore t'i jepet prioritet bashkëpunimit ndërinstitucional. KShH propozon ngritjen e një sistemi menaxhimi brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ky sistem do të shërbente si një platformë e centralizuar për të gjithë palët e interesuara për të bashkëpunuar si një organizëm i unifikuar, duke ofruar mbështetje dhe mbikëqyrje të proceseve përtej përgjegjësive të tyre individuale. Nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë, ky organ koordinues mund të forcojë ndjeshëm përpjekjet për të luftuar kontrabandimin e migrantëve. Një aspekt integral i këtij sistemi do të ishte shkëmbimi dhe menaxhimi i të dhënave, duke siguruar koordinim efikas të informacionit. Një sistem i tillë i menaxhimit integral bëhet veçanërisht i rëndësishëm kur trajtohen rastet që përfshijnë të mitur ose të mitur të pashoqëruar.
6. Mbështetja e Frontex-it dhe bashkëpunimi rajonal luajnë një rol të rëndësishëm në trajtimin e sfidave që shtrihen përtej vendeve individuale, siç është kalimi i paligjshëm i kufijve. Krijimi i pikave të përbashkëta kufitare është një hap i rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit me agjencitë e zbatimit të ligjit në vendet fqinje. Është e rëndësishme që të vazhdohen përpjekjet për mbikëqyrjen e përbashkët të kufirit dhe kryerjen e operacioneve të përbashkëta për të trajtuar në mënyrë efektive bashkëpunimin ndërshtetëror mes kontrabanduesve. Kjo qasje bashkëpunuese do të kontribuojë në kontrollin më efektiv të kufirit dhe kundërveprimit ndaj aktiviteteve të paligjshme të kalimit të parregullt të kufirit.
7. Është thelbësore që kontrabanduesit e kapur të përballen me pasoja ligjore për aktivitetet e tyre të paligjshme. Dënimi i tyre sipas ligjit është thelbësor, pasi do të rrisë ndërgjegjësimin për veprimet e kontrabanduesve dhe do të dekurajojë mbështetjen e ardhshme për migrantët e parregullt. KShH inkurajon agjencitë ligjzbatuese dhe gjyqësorin (prokuroritë dhe gjykatat) që të hetojnë dhe shqyrtojnë me përparësi çështjet e procesimit penale që përfshijnë nëpunës civilë, si p.sh. oficerët e policisë. Duke i trajtuar këto çështje me seriozitet, do të përcillet një mesazh i qartë që do të ndihmojë në mos përfshirjen e individëve në aktivitete kontrabandimi.
8. Është vërejtur një rritje e përdorimit të automjeteve të marra me qera nga kontrabanduesit për transportin e migrantëve. Në këtë kuadër, KShH rekomandon që agjencitë ligjzbatuese të rrisin bashkëpunimin me sektorin privat që ushtron veprimtarinë në këtë industri. Duke forcuar këtë partneritet, synohet zbulimi

dhe identifikimi i kontrabanduesve në fazën më të hershme të mundshme dhe dekurajimi i përdorimit të makinave me qera si mjet transporti për aktivitete të paligjshme.

9. Rritja e ndërgjegjësimit të migrantëve të kapur për të drejtat e tyre dhe procedurat e nevojshme që ata duhet të ndjekin është thelbësore. Për ta arritur këtë, KShH u sugjeron aktorëve kryesorë dhe OJF-ve që të kontribuojnë në mënyrë aktive nëpërmjet materialeve informuese si fletëpalosje, postera dhe video në gjuhët që migrantët mund t'i kuptojnë. Duke ofruar burime të aksesueshme, migrantët do të pajisen më mirë me njohuritë që u nevojiten për të kuptuar situatën e tyre dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre në mënyrë të përshtatshme që të mos bien viktima të kontrabanduesve.

